

*Petroq Zoto*

# NDËRGJEGJJA

854 - 32

Z 91.



85H-32

Z41

85H-32

S

BIBLIOTEKA E MIKUT TË VOGËL TË LIBRIT

PETRAQ ZOTO

# NDËRGJEGJJA

~~42312~~

BIBLIOTEKA E SHETËR  
D. BRUNAS RRP  
3510

SHETËRIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

## TIRKA

**T**akimin me xha Baton pionierët e pritën me kënaqësi të madhe. Ai vërtet fliste pak ngadalë, po, ama, fjalët i kish plot kripë e ndodhirat i tregonte si asnjë tjetër.

Plaku hyri në klasë aty në të thyer të diellit.

Mirëpo akoma ish nxehtë, sepse dritaret e klasës binin nga perëndimi.

Xha Batua shikoi nja dy herë nga dritaret dhe shtrëngoi sytë, nga që nuk i duronte dot rrezet verbonjëse të tij. Dukej që s'e ndjente veten mirë.

— Ore, shoku mësues — tha — A nuk vemë atje nën hie dhe ja shtrojmë vënçe? Këtu unë s'marr dot nefeks. Apo s'qënka vapë!

Ashtu u bë. Xha Batua u ul këmbë-



kryq nën hien e një kumbulle gjatore në oborrin e shkollës, ndërsa fëmijët e qar-kuan nga të gjitha anët.

— Këtu po, jemi të shpënguar — tha plaku. — Epo, ja fillojmë? — shtoi duke shikuar fëmijët.

— Nisja, xha Bato, nisja! — iu lutën ata.

— Që thoni ju, sot do t'ju rrëfej për një partizan të vogël ja, të vërsës suaj.

— Mirë, mirë! Po nisja sa më parë! — thanë disa fëmijë të paduruar.

— Ama mos më nagasni kështu! Ne pleqtë e kemi avash-avash, se ndryshe e humbim fare pusullën, apo jo, o shoku më-sues?

Mësuesi qeshi, qeshi edhe plaku, pastaj përdrodhi mustaqet, e ndezi çibukun dhe u tregoi fëmijëve ngjarjen e mëposhtëme:

«Behari sapo kish hyrë. Një mëngjes kishin sulmuar një kollonë gjermane. Pas-taj muarëm ç'mundëm prej maqinave që po digjeshin dhe ja mbajtëm përpjetë. Kishim marrë armë e municione, po edhe plot ush-qime. Hëngrëm mirë e mirë dhe i falnde-ruam ata nencët që na ardhën në shteg që me natë, se do të kishim vlagë për ndonjë



javë prej asaj dreke. Pastaj po rrinim e po çlodheshim në pyll.

Atje na vjen një djalë i vogël. Kish mbathur një palë pantallona të shkurtëra e të vjetra, kish vënë në kokë një kapelë prej karte, po e kish bërë allapartizance, qerrataj, dhe i kish vënë edhe një goxha yll të kuq prej plaçke.

Si përshëndeti, na pyeti.

— Cili prej jush është komisari, këtu?

«Paska punë me rëndësi, shejtani!» thashë me vete, se s'më pëlqeu hiç që vriste lart e s'na e vari neve.

Si mori vesh cili ishte komisari, tha me mburrje:

— Unë dua të bëhem partizan e të luftoj me ju!

Komisari s'desh ta pranonte në fillim, po e pa qe djali s'tundej, dhe bëri udhë.

— Si të quajnë? — e pyeti duke nxjerrë bllokun e tij të shënimeve.

— Sotir! — thirri ay.

— Sotir — përsëriti komisari duke shënuar në bllok.

— Sotirkë! — ja bëri një partizan — E ku është për Sotir ky?

— E, që të mos e zgjatim shumë, ay partizani tha se djalit duhej t'i thërrisnim Sotirkë ose Raqi, po një tjetër u hodh e tha se do që më mirë ta quanin Tirkë. Kjo na pëlqeu të gjithëve, e kështu, që nga ay hop atij trimit i la shëndenë ay emri prej të madhi.

Tirkën e veshnë që atë ditë si kallëp misri. Një shoku ynë kish qënë robaqepës dhe ja ujdisi për bukuri një palë rroba gjermani.

Që thuani ju, komisari ma la mua në kujdes atë Tirkën. «Xha Bato, ja vërë ca veshin atij djalit — më tha — Po kij kujdes; se duket ca sherret. Do të kesh përgjegjësi për të!» Posi, posi, tamam kështu më tha.

Atë natë, s'i fola fare djalit të vogël. Kur më avitej pranë e më fliste, mua më vinte t'ja ngjeshja surratit. «Pse, me fëmijët do të merrem unë? Prandaj kam rrëmbyer dyfegnë?» Kështu thosha me vete. Mirëpo urdhëri është urdhër. Unë isha partizan e s'mund ta thyeja urdhërin e komisarit tim. Ama atë Tirkën e kisha qejf ta zhdepja një herë paq! Po ç'e do se u bëra pishman më vonë. Ky Tirka, që thu-



ani ju, na doli jo siç e pandehmë ne. Nuk  
qe mëndje madh e mistrec, po një djalë  
për kokë të djalit. Trim e deshe? Kurrë s'i  
trëmbej syri! Të zgjuar e deshe? Shejta-  
nit i jepte xhevap! Apo i shkathët! En-  
gjervi fare ish! Kurrë s'dinte të lodhur.  
Apo s'këndonte! Po, po, Tirka këtej, Tirka  
andej, kudo e thërrisnin e kudo gjëndej  
ay. Ish gëzimi i ne të gjithëve.

Shkollë s'kish bërë fare, po brënda  
ca ditëve na e kaloi neve, gërxfrove, që  
kishim filluar të mësonim atje, në mal, e  
që ja kishim fryrë kokën mësuesit për ja-  
vë të tëra. Ai që na mësonte kish qënë  
vërtet mësues. Ama ish mërëzitur me ne,  
se ku fëmijët që e kanë trurin të njomë  
e ku ne! Dhe e dini ç'thosh gjithënjë  
kur ne s'nxinim fare? «Oh, unë s'paskam  
qënë mësues i mirë!» Po ja ku ardhi Tir-  
ka, që i kuptonte menjëherë mësimet dhe  
na ndihmonte edhe ne. Të shihnit ç'të gë-  
zuar që u bë mësuesi. «Të falemnderit, o  
pëllumb, — i thosh — se ti më ngjalle  
besimin në forcat e mia!»

Të na e morën me sy të mirë të gjithë  
këtë Tirkën, o djem, dhe njeri ja rregu-  
llonte kapellën, tjabtri i gjente këpucë. Mo-



re i gjetën edhe një automatik të vogël që aman aman! Dhe u bë Tirka si djalë i vetëm!

Mua më takonte ta mësoja për çdo gjë. Dhe e dini sa pyeste? More sikur ishte pjellë vërtet për të pyetur! Për besë! I thashë një ditë të mos kërkonte t'i dinte të gjitha, se do të mplakej shpejt, po e dini si më tha? «Më mirë të mplakem shpejt, se të mos di!» Sidomos sa i mori dorën atij qerrata automatiku, lere, lere! . . .

Po si e mësoi atë mirë e mirë, na u bë më i besdisshëm.

«Kur do të luftojmë me gjermanët? Pse, kështu luftohet? Të rrimë duarkryq? Kur do ta provoj automatikun tim?»

Ja, të këtilla pyetje na bënte çdo hap.

Më në fund, ardhi dita që ta provonte edhe ay automatikun e tij.

Ish vakt zëmre. Gjermanët po vinin drejt nesh. Siç, na tha një fshatar, ata deshnë të digjnin një fshat e pastaj të na e merrnin krahun neve. U bëmë gadi t'u delnim përpara. Zbritëm poshtë e zumë vënd në të dy anët e rrugës. Atje ish një pyll i dendur me bush. Ne ishim pak, po

vëndin e kishim të volitshëm e ishim të sigurt se do të korrnim fitore.

Tirkën e kisha pas. Bëmë çmos ta linim me shokët e tjerë atje lart, po ku dëgjonte ay! Aq i paduruar ish bërë, sa që mezi i pritej sa t'i shihte gjermanët. Herë-herë ngrihej nga pozicioni dhe shikonte poshtë. E zija për pallto dhe e ulja.

«Ç'bën more, apo të shkosh për dhjamë qeni?» i thashë.

«Ç'domethënë» të shkosh për dhjamë qeni «o Xha Bato» më pyeti.

«Mor shejtan, po edhe këtu s'm'u ndave me këto të mallkuar pyetje? Ay vakt është tashti?» i them dhe po shfryja me vehte i zëmëruar.

«Më fal, xha Bato, mos u mërzit. Po pastaj do ma shpjegosh, ama? Mirë?»

Dëgjoni ju se ç'i çuditshëm djalë që ish?

«Eh, pastaj!» i thashë dhe desha të shtoja se pastaj unë e ay mund të kishim zënë ndonjë gropë, po e mbajta veten, se nuk duhej dëshpëruar ay shejtan. Mirë-po ay e mori vesh.

«Mos u bëj merak, xha Bato! Nuk



na gjen gjë ne! A nuk luftojmë për të drejtën? Ai që lufton për të drejtën, fiton!»

Ecë e t'i jepje përgjigje! S'e ngava më tutje dhe ula kokën. Po ay prapë ngrihej dhe lëvizte nga vëndi. Si e pashë keq, vendosa ta provoj ndryshe.

Ore i mallkuar, i them, a e di ti se jemi partizanë?»

Oj, ç'thua kështu, xha Bato? Këtë e di edhe bufi!»

«Bufi mund ta dijë, po ti, ama, s'e ditke!»

Ay po habitej.

«Posi, ore, pse, kështu i thyen urdhërat partizani? Ne kemi zënë pritë, kurse ti nuk zë vënd. Po sikur gjermanët të na pikasin prej teje? E humbëm davanë, pastaj! Ja, kështu po bën ti!»

Me t'i dëgjuar këto fjalë, kafshoi buzën e as foli, as lëvizi më. Rrallë dëgjoja të lëvizte shulin dhe psherëtinte.

Dielli po varej poshtë. Dësh akoma edhe ndonjë hosten që të fshihej pas malit. Ish një diell i kuq e i math sa një pogaçe. E kishim përpara e na vriste sytë.

Shkoi një orë, shkuan dy. Hunda po




më çahëj. S'rrija dot në vënd, sikur më kish zënë zekthi. Duhani kisha, por na ish ndaluar ta ndiznim. Po e vërtitja kuintë në duar, vija ca fije duhani në hundë, po çne! Më tepër më pihej. Kur dëgjoj Tirkën të më thotë ngadalë duke iu dredhur zëri:

— Po vijnë, po vijnë!

Vërtet, gjermanët çatisnë! Edhe urdhëri për të qëlluar u dha. Sa të thuash pasë, gryka e malit u mbush me tym, me krisma e me thirrje. Një gjerman u shtri i vrarë në rrugë. Nuk di se kush e kish qëlluar, unë apo Tirka. Dy të tjerë, që ishin me të, bënë përpjetë të na e merrnin krahun.

«Tirkë, i them, ti rri këtu, se unë po u dal përpara atyre qënërve».

S'mora përgjigje. U trëmba dhe ktheva kokën me rrëmbim, po Tirka s'ish pranë meje. Djall punë! Ç'u bë? Hedh sytë andej këtej, kur e shoh: kish dalë atje ku desha të dilja unë. I egjuar ish shejtani. Ma kish blerë mëndjen me vrimat e hundës! Kish zënë vënd pas një shkëmbi e po priste. Unë u ngrita të vija tek ay, po atë hop pashë një oficer gjerman, që u





stapit mu përpara Tirkës, sikur të kish mbirë nga dheu. Dielli i binte prapa dhe hieja e tij u zgjat e u zgjat. Kushedi si do t'i jetë dukur Tirkës!

«Tirkë, bjeri!» i thirra dhe ja drejtova edhe unë dyfegnë atij qafiri.

Dëgjova një breshëri automatiku dhe e pashë atë stërhellin të shëmbet poshtë.

«Hë, të lumtë, o trim! — thashë — E bëre më shëndet!»

I afrohem. Tirka ish i verdhë dyllë e dridhej. Më iku gjaku. Thashë se mos ish plagosur dhe e rrëmbeva në krahë.

«Jo, xha Bato, s'kam gjë — më tha — Po kur ai oficeri më dolli përpara mu këtu ku s'e prisja se si më ardhi...»

«Ama kështu qënka puna! Atë e dërgove në xhegnem të gomarit, po shiko të tjerët!...»

E ç'të tregoj më tej për atë luftë? Në luftë, mor djem, të ndizet gjaku e s'para merr vesh se ç'bëhet. Ne bam, e ata bam. Ndaj të errur dëgjojmë urdhërin për t'u tërhequr. Mësuam se kishin ardhur gjermanë të tjerë e po na e merrnin krahun. Vërtet që kishin vrarë shumë prej tyre,



por s'mund t'i linim edhe kokat tona aty, se na duheshin për më pas.

U mblodhëm të gjithë në vendin prej nga ishim nisur. S'ish vrarë asnjë nga tanët. Vetëm dy shokë ishin plagosur.

Unë u shtriva të çlodhem, kurse Tirka, sa mori vesh se ishin plagosur dy shokë, shkoi t'i ndihmonte. Ai ish shpuzë, ose, s'lodhej kurrë!

Komandanti na tha se gjermanëve u kishin ardhur forca të tjera që ne nuk e kishim parashikuar, kështu që, megjithëse kishim luftuar si luanë, na u desh të tërhiqeshim.

Pastaj ne ishim në hall se s'dinim ku vajtën gjermanët, kishin hyrë në fshat e kishin ikur prapë.

Me këto mejtime, vëmë të flinim. Unë pija duhan. Tirka ish shtrirë pranë meje. Nuk flinte. Edhe ai mendohej.

«Xha Bato — thotë papritur — pse na duhet kaq shumë të dimë se ku mbetnë gjermanët sonte?»

«Na duhet, or bir — i them — se, po t'i dimë ku janë, i rrethojmë pa na marrë vesh.»

«Ohoho! E pastaj? Ç'do të bejnë ata?»

«Gjermanët? Do thërresin «Hale Hitler!» që në gjuhën e tyre do të thotë «Shëndet Hitlerit!» a «Rroftë Hitleri!», zëre si ta zësh, po ne e kthejmë në shqipe të kulluar «Hale Hitler!», se është një hale ay Hitleri i tyre që. . . »

Tirka u gajas se qeshuri. Qeshja edhe unë me shijen e tij, si budallai.

Pas ca kohë më pyeti prapë:

«Domethënë, po t'i dimë ku janë, ua rregullojmë samarin, ë?»

«Po» i thashë.

Ay s'pyeti më. U kthye nga ana tjetër dhe e zuri gjumi, ashtu bënte, djalli po ku ta dija unë!

Nata ish e errët, pa hënë, po yje kish plot. Me sytë përpjetë unë shikoja xixëllimën e tyre. Pas pak ato zunë të vallzonin para meje: më kish ardhur gjumi. M'u duk sikur ndjeva një zhurmë të lehtë, po s'u zgjova dot menjëherë. Kur i hapa sytë, Tirka s'ish atje.

«Tirkë! O Tirkë!» — thirra ngadalë.

S'm'u përgjigj njeri.

«Ej, ç'më polli groshi me këtë shejtan!» thashë me vete.

Kush i dilte përpara komisarit tani!



Gjumi më dolli fare. Prita një orë, dy — Tirka s'po vinte. Pashë, ç'pashë, i vajta komisarit. I thashë si qe puna. Komisarari s'më tha gjë, po a më dilte e keqja mua?

Si u mendua pak, ai më pyeti:

«Mori vesh Tirka që ne ishim në hall për të ditur ku vajtën gjermanët?»

«Eh, mor shoku komisar! E ku i mbetet gjë pa mësuar Tirkës?»

Dhe ja, tregova bisedën që kisha bërë me të.

Komisari u ngrit më këmbë.

«Ta ka hedhur, xha Bato!» tha.

«Mua të ma ketë hedhur?»

«Po, po. Të ka vënë në gjumë ty dhe vetë ka shkuar për zbulim. Po tani si i bëhet? Do na e zënë Tirkën!»

Komisari u bë fill. Dukej më i merakosur se unë.

«Ne nismë shokë për zbulim — shtoi — Tirka s'e di parullën. Ah, mor Tirkë!...»

U nismë ta kërkonim. Po ku të vinim? Muarmë rrugën e fshatit. Sa bëmë për poshtë, dëgjuam zhurmë. Dikush po ngjitej monopazit duke ngulçuar. Thamë se



mund të qe edhe ndonjë egërsirë. Sidoqoftë, u fshehmë. Kur afrohet, ç'të shohim?

Tirka jonë! M'u ngroh zëmra e sikur u shkarkova, po e ndjeva veten si të lodhur e të kapitur. Ndoshta sepse kisha patur shumë gjale për të!

«Do t'i jap një mësim të mirë!» thashë dhe bëra ta trëmb. Po për pak më piu e zeza, se ma drejtoi automatiknë. I thamë se kish vepruar në kundërshtim me rregullat partizane, po ay s'na e fërshëlleu fare nga ajo anë.

«Më vonë më thuani për këtë — tha. Tani më thuaj edhe një herë: a mund t'i rregullojmë e t'i zhdukim gjermanët, po t'i dimë ku janë?»

«Po» thashë.

«Unë e di ku janë! Po flenë në fshat.» Na tha pastaj se kur zbritëm për t'u zënë pritë gjermanëve, ai kish takuar një versnik të tij, çoban. Ky e kish shtëpinë në anë të fshatit. Tamam tek ay kish vajtur natën. Dhe bashkë me çobanin e vogël kishin kallauzitur.

Brënda gjysëm ore, bataljoni ish gadi. Pas një ore gjermanët e gjetnë vëndin. Kur u mblodhmë përsëri, komisar i lav-

dëroi Tirkën para bataljonit të rrjeshtuar, po i tha edhe se po të bëntë më veprime të tilla në kokë të tij, do t'a dënonin rëndë.

Po Tirkës s'i bëhej vonë nga këto.

Atë ditë fluturonte nga gazi. Më për-qafonte dhe më tregonte ç'kish parë kur i zhduknë gjermanët.

Në mbrëmje muarmë një udhë të gjatë.

\* \* \*

Këtu xha Batua e ndërpreu rrëfi-min sikur të desh të kujtonte ç'kish ndo-dhur më tej.

— Po pastaj, o xha Bato? — pyeti një pionier.

Xha Batua u shkund nga mendimet e vazhdoi:

— Ca muaj para se ta çlironim Shqipërinë — tha — Tirkën e muarnë në shtabin e brigadës dhe e bënë korjer. Mue më ardhi edhe keq edhe inat, se e kisha bërë partizan të vërtetë dhe isha mësuar me të, po. ....

Fëmijët e kuptuan se xha Batos i kish mbetur peng në zëmër ay transferimi



i Tirkës, për më tepër se nuk e kishin pyetur fare.

— Po mbaroje, o xha Bato, a nuk e sheh se s'na pritet sa të mësojmë fundin? Ç'u bë Tirka? Mos u vra?

Mësuesi shikoi me vërejtje nga plaku, po ky s'i mori aspak për keq fjalët e fëmijëve.

Tha si i çuditur nga këto pyetje:

— Tirka të vritej? Ama mëndje! E ku e zinte plumbi atë shejtan? U plagos një herë, xhanëm, po plumbit nuk ja kish mbajtur ta shponte tej për tej dhe e kish marrë anash, në pulpë!

Fëmijët qeshën.

— Po tani ku është Tirka? — nxittoi e tha njeri.

— Hej, sa të rrëmbyer që qënki! Prisni, ore, unë s'kam mbaruar, a nuk ju thashë që më parë se do t'ja marrim urtë e butë?

Plaku qeshi e mësuesi dukej i kënaqur, sepse fjalët e tij ishin më tepër lavdërim se qortim.

— Këtu e ca muaj më parë — vijoi Xha Batua — m'u dha rasti të vete në Tiranë, se më dhimbnin keq sytë. Zbrës nga

treni e ja marrë avash-avash. Kur dal te bulevardhi, ç'të shoh! Dritat llapsin, njerëzit të gëzuar venë e vijnë. Ishin aq shumë sa thashë se kish ndonjë mbledhje të madhe. E humba toruan, që thoni ju, e s'dija ku të vete. Tirana, o bijtë e mi, nuk qe ajo që mbaja mënd unë. Pastaj tërë këta njerëz, tërë këto drita... më dukej sikur kisha zbritur në një botë tjetër.

Kur shoh një djalë të gjatë që po më avitej duke qeshur. Ish veshur si dhëndërr. Më shikonte e qeshte. Seftë u inatosa, po pastaj vrava mëndjen: «Ku e kam parë këtë njeri xhanëm? ku i kam parë këta sy që shkëlqejnë? Kush qeshte kështu?» Nuk kujtohesha dot. Ai djali më thotë:

«Xha Bato, si të kam?»

Unë mbeta gojëhapur. Ku ma dinte emërin mua?

«Nuk e mban mënd Tirkën?» tha djali.

Zëmra m'u hodh përpetjetë. Tirkën të mos e mbaja mënd unë? Ai ish Tirka! Tirka vështronte ashtu, Tirka qeshte aq ëmbël! Hej dreq! Si s'e njoha dot menjëherë!

U qafuam aty disa herë.



«Ore Tirkë — i them — po ministër je bërë, mor shejtan?»

«Jap mësim në Institut, xha Bato, jam mësues tani.» më thotë ai.

«Shiko, shiko. Po ku e gjete shkollën ti, bre?»

Ai gjithë duke qeshur më tha se menjëherë pas çlirimit e kishin dërguar në shkollë. Dhe kish bërë shkollë të madhe, shejtani!

«Demek kështu — i them — Dhe më qënke spillosur, o Tirkë që...»

«Xha Bato, epo s'jam bërë akoma për Sotir?» më thotë.

«Ti për Sotir? Po, unë atëhere, përse qënkam bërë? Se edhe mua Xha Bato më thoshin kur ty të thërrisnin Tirkë.»

Pastaj ja bëra qejfin.

«Je bërë, bre, je bërë. Veç shiko, ama: mos e harro Tirkën! Mos i harro edhe tërë ato që lidhen me këtë emër! Se ai që harron të tilla gjëra, kurrë s'sheh mbarësi në jetë.»

Ay më tha se nuk do t'i harronte asnjë herë. Më mori për krahu e më shpuri në shtëpinë e tij. Po që t'ju rrëfej ç'bëmë e ç'thamë atë natë duhet një natë dimëri,

o djem. Ç'thuani, e lemë me kaq për tashi?

Si pyeti kështu e si bëri ca shakara, plaku u ngrit e shkoi. U ngritën edhe fëmijët. Po asnjëri s'fliste. Secili e kish mëndjen te Tirka, te ai partizani i vogël, që kish qënë aq trim kur ish në moshën e tyre.



## X H A K E T A

Koçua me Gaqin vinin në shkollën 8-vjeçare ose unike, siç i thoshin atëhere. Gaqi kish kuturisur i pari për ta ndjekur këtë shkollë. I ati desh ta dërgonte tek e motra, në qytet, të rrinte atje dhe të vazhdonte edhe shkollën, mirëpo atë mot 7-vjeçarja u hap në lokalitetin e tyre. Koçon, që ish bërë pikë e vrerë, sepse më parë s'gjente dot mënyrën si të vinte edhe ai në shkollë, sapo e mësoi këtë lajm, s'e nxinte më vendi.

«Tani s'do të mbetem më prapa Gaqos — thosh me vete — Vërtet do ta kem ca më vështirë, se është larg, po pa shkollë nuk do të rri, ama!»

Që atë çast vrapoi ta gjente shokun e tij.

Aq i gëzuar ish, sa që iu hodh më qafë atij duke i thënë:

— Gaqi, edhe unë do të vete në unike! E more vesh? Sivjet do të hapet unikja në lokalitetin tonë!

Edhe Gaqi ish gëzuar. I qe përgjegjur:

— Kur qenka puna kështu, unë nuk vete në qytet, do të vij me ty!

Pastaj ishin përqafuar përsëri dhe kishin shpejtuar t'ua thoshin këtë vendim prindërve të tyre.

Disa ditë më pas ata filluan shkollën e re. Vinin e ktheheshin çdo ditë. Ditët e para lodheshin shumë, po s'e bënë veten. Pastaj u mësuan. Gëzimi që po vazhdonte një shkollë më të lartë, i bënte të mos e ndjenin lodhjen e mërzitjen.

Kishin qenë shokë të mirë që në fillore. Bashkë rrinin në bangë, bashkë edhe mësonin. Dhe mësonin shumë. Edhe tani bashkë rrinin, bashkë shkonin në shkollë e bashkë mësonin. Prapë duheshin shumë dhe s'mërziteshin fare. E kishin bërë zakon që, sa niseshin nga shkolla, fillonin bisedën mbi mësimet që kishin bërë atë ditë. Kjo i ndihmonte, se e kishin më lehtë për të mësuar. Me një rrugë, dy punë: edhe kalonin pa e vënë re një pjesë të mirë të udhës edhe i përforconin njohuritë



që kishin marrë. Po rruga ish e gjatë dhe fjalët u mbaroheshin. Gaqi, që ish shejtani vetë, gjente atëhere ndonjë shkak për të larguar mërzinë. Ja, një ditë gjeti në rrugë një kuti mishi të zbrazët dhe e bëri atë si top futboll. I binin herë njëri e herë tjetri, ndiqnin me sy vrapimin e saj të bujshëm, qeshnin një copë herë me të.

— Do ta shpiem gjer në fshat, mirë?

— Mirë!

Po pak më tej, e linin këtë kuti për ta ngarë të nesërmen. Pastaj, meqë s'kishin ç'të thoshin e ç'të bënin më, ja hidhnin njeri tjetrit dorën në qafë dhe ja merrnin ndonjë këngë ose ecnin duke kërcyer.

Sikur mos e deshnin shumë njeri-tjetrin, patjetër do t'u ish mërzitur ca kjo rrugë dyorëshe. Po kish edhe arësye të tjera që djemtë e vegjël s'e vinin re udhën e gjatë. Kur ktheheshin në fshat, u tregonin prindërve ndonjë gjë interesante që kishin mësuar.

Një ditë, Koçua e tregoi aq mirë në shtëpi «Odisenë», sa që e ëma e kish puthur duke thënë me lot në sy:

— Sa mirë rrëfen, shkollari i nënës!

Edhe i ati ndjehej i kënaqur. Koçua

e kuptoi që i ati e shihte si njeri të rritur e të zgjuar, kur e kur, ky i jepte të bën- te ndonjë hesap ose të lexonte gazetën. Pa kish edhe raste kur i thosh mbrëmanet:

— He, o djalë, pa na trego ndonjë his- tori nga ato të shkollës!

Veç të shihnit Koçon si i ndritte fy- tyra në ato çaste! Tregonte me qejf, dhe dëshira e zelli për të mësuar sa më shumë i shtoej e i shtoej. . . .

Kështu, si djem të zgjuar e të ditur, e mbanin të gjithë në fshat, se asnjë, veç mësuesit, nuk kish bërë më tepër shkollë se filloren. Se e shihnin kështu, Koços i rrinte mëndja gjithë tek ajo fanella e tij prej leshi që mbante. Kur do të vinte dita që ta hiqte atë e të vishte një xhaketë? Atëhere po, do të dukej tamam i rritur e shkollar i vërtetë!

Kjo dëshirë e mundonte edhe më te- për, se s'ja thosh dot as njeriu. Nuk mund t'ua tregonte prindërve. Jo, nuk duhej! Ai e dinte gjëndjen e familjes. Ishte viti i dytë i çlirimit. S'e kish harruar ai se sa kishin vuajtur në vitet e luftës. S'e kish harruar ai sa herë kishin mbetur pa bu- kë e se si gjermanët e ballistët s'u kishin



lënë gjë në shtëpi. S'i kish harruar ai partizanët, me të cilët e ndanin kafshitën e gojës. Natyrisht, ai s'i kish harruar edhe fjalët e tyre mbi të ardhmen e lumtur.

— S'na lanë gjë, qentë! Po shyqyr zotit i shporrëm! Tani jemi të lirë e do t'ja fillojmë për së mbari.

Vërtet kështu kishin filluar. Mirëpo vetëm me urdhërin e peshkut mund të plotësohet menjëherë çdo nevojë! Edhe këtë e dinte shkollari i vogël. Prandaj s'e përmendte fare ai atë dëshirën e tij të zjarrtë për të patur një xhaketë. S'i kish ardhur radha asaj. Mirëpo edhe ajo fanelle e kruspullosur gjer në grykë...

Si për t'iu lënduar më tepër zemra, një mëngjez e pa shokun e tij të veshur me një xhaketë stofi blu. Atë çast e kup-toi se sa e madhe qe dëshira e tij dhe, meqë nuk e kish plotësuar, iu duk vetja e mjerë. Iu afrua Gaqit e i tha duke ja shikuar me sytë gati të mbushur me lot.

— Kur e paske bërë xhaketën? Sa mirë të rri! Ta mbash me shëndet!

Dhe e kish kthyer në shaka tronditjen e tij, duke e cimbisur në krah kur e uroi. Po vjedhur e shihte shokun me bisht të

syrit. Me atë xhaketë të re Gaqi i dukej si i huaj. Bile atij i vinte zor të tregohej si më parë ndaj tij apo t'ja hidhte dorën në qafë tjetrit. Xhaketa ama, vërtet e tregonte më të rritur shokun e tij. Ajo linte t'i dukej mirë këmisha, supet e ngritura e tregonin shpatullgjerë, ç'them: tamam burrë, e!

Shikonte pastaj atë fanellën e tij të zbardhur dhe i dukej sikur do ta mbyste. Nganjëherë thosh me vete: «Edhe unë me siguri do të bëj një të tillë së shpejti. Pse, s'mbante edhe Gaqi më parë këpucë me pjesën e poshtme prej dërrase e të sipërmen prej mushamaje? Po ja, tani bëri xhaketë. Edhe unë do të bëj së shpejti.»

Kështu e qetësonte shpesh veten, megjithatë...

Kaluan ca ditë të tilla plot dëshpërim për të, kur një mbasdite, sa ishin kthyer nga shkolla, e motra i pat thënë:

— Hajde të vemë tek Vangjeli të të marrë masë për xhaketë!

Merreni me mend se si mbeti Koçua! A kish dëgjuar mirë? Vërtet do të kish edhe ai xhaketë? Vërtet po i plotësohej kaq kollaj ajo dëshira e tij aq e madhe?



Po ai askujt s'i kish thënë gjë për të! Ama, e motra do ta kish kuptuar se ai e shih-te shpesh si me inat atë fanellën e tij të vjetër. Ajo do ta kishte kuptuar e do t'i kishte thënë babait.

Ky mendim e bëri të skuqej.

— He, ore, ç'rri si i shastisur? — e shkundi e motra.

— Me të vërtetë?! — e pyeti i habitur ai. Pastaj shtoi: — Mos ke thënë gjë ti?

— Ja, përse u bëka merak, budallai! Babai tha se po vjen dimëri e ty të duhet një xhaketë, se je shkollar i mirë e goxha djalë tani.

Ai e përqafoi motrën e shkoi me të te rrobaqepësi.

Të nesërmen nuk kish më druajtje prej Gaqit.

— Edhe unë do të bëj xhaketë si tënden! — i tha atij.

Kur e veshi xhaketën e re, iu duk sikur kish zënë qiellin me dorë. U shikua mbarë e prapë në pasqyrë dhe u bind se ajo i vinte shumë mirë pas trupit dhe se vërtet e tregonte më të rritur. Këtej e tutje kalemin, ndonjë copë letër e fshirësin do t'i mbante me vete kurdoherë. Apo

s'kish ajo xhaketa e tij edhe xhep nga brenda, edhe xhepkë të vogël, edhe... E ç'i mungonte asaj? Tani ai s'kish më pse të ankohej. Xhaketa i pëlqente shumë dhe e ruante si sytë.

Kur filluan shirat e vjeshtës, të dy shokët zunë me qira një dhomë atje, në lokalitet, se s'vinin dot çdo ditë në shtëpi, mbasi përrenjtë shpesh bëheshin të pakalueshëm. Pastaj ardhni dimëri. Djemtë e vegjël vinin në fshatin e tyre veç të shtunën. Drutë e rrobat për të fjetur ua kishin shpënë atje. Ushqimin e merrnin nga shtëpia për tërë javën. U mësuan shkollarët e vegjël ta bënin çdo gjë vetë. Njëri priste dru, tjetri ndizte zjarrin, pastaj bënin ndonjë gjellë të thjeshtë, lanin enët e fshinin si shtëpiakë të vërtetë. Vetëm me dritën e kishin keq. Kishin marrë nga shtëpia një llambë, po se si qëllonte që asaj i thyhej gjithëmonë qelqi. Një herë kur e fshinin, një herë kur e shtrëngonin në vitllë, një herë çahesh vetiu, sepse e kishin vënë të lagur. Aq u mërzhiten me të, sa që e ndërruan me një fanar të madh që shkruante pranë vidës: «Made in Germany»...



Duke ndenjtur mbrëmave secili në krevatin e vet, ndonjëri e shihte markën e këtij fanari dhe aty për aty ja nisnin një bisede të gjatë.

— Nga lufta ka mbetur ky fanar, me siguri.

— Kushedi kush do ta ketë përdorur!

— Kushedi sa nga ata që e kanë përdorur, s'rrojë më!

— Ama, të ashpër ishin, ë!

— Po naa u vinin prej partizanëve, ama! Të kujtohet kur i zunë ata gjermanët te shkolla?...

Dhe muhabeti zgjerohej e zgjatej.

Një mbrëmje ata vunë re se fanari i madh s'jepte dritë të mirë e shpesh bënte fap-fap.

— Do t'i jetë mbaruar gazi — tha Gazi — Ti fshije qelqin e unë po i shtie ca.

Si tha kështu, ai e mori fanarin në duar, ja hoqi qelqin, të cilin ja dha shokut, ja hoqi edhe vidën dhe filloi t'i shtinte gaz prej një shisheje. Secili bënte punën e tij. Koçua e hoqi xhaketën që të mos i ndotej, e vuri atë mbi karrige dhe mori copa letrash për të bërë punën që i caktoi shoku. Papritur dëgjoi një zhurmë që i ngjiste shpërthimit të barutit.


Dhoma zbardhi nga një ndriçim i fortë. Ai dëgjoi një klithmë të fortë dhe kur u kthye pa se si Gaqi ra në dysheme i prap-sur prej frikës. Këto ndodhën aq shpejt sa që Koçua u tremb e mbeti si i ngrirë. Pastaj e kuptoi si ish puna: kish marrë zjarr gazi. Kur Gaqi ra në dysheme, gazi iu derdh në duar e ato i muarën flakë. Ai dukej shumë i hutuar nga frika. Mundohej ta shuante flakën duke e fryrë e duke i tundur duart. Po kështu ajo ndizej më keq. Edhe Koçua e humbi toruan. Po shpejt u kujtua ç'duhej të bënte. Duhej mbuluar flaka! Mjeti që iu ndodh më afër, ish xhaketa e tij e re. Ai as që u mendua fare. Shoku po digjej...

— Mos i fry flakës, po shtriu përmbys!  
— thirri; rrëmbeu xhaketën dhe ja hodhi sipër. Flaka s'u platit e tëra. Ai rrëmbeu nga krevati batanijen dhe e hodhi edhe atë mbi flakët e gazit. Batanija e madhe i mbuloi krejt ato. U bë një errësirë e dendur pus. Duke hapur sytë të shihte ç'u bë, Koçua ndjeu se ato i dogjën prej tymit. Pastaj ndjeu edhe erën e rëndë të gazit dhe e kuptoi se flaka ish shuar plotësisht.

— Gaqi, ngreu! Ku je? A u dogje shumë?

— Jo, jo, veç dora m'u përcëllua ca.





— Po si rrije kaq në heshtje? Sa u tremba!

— E mblodha mendjen shpejt — tha ky. — Po të kisha lëvizur, do të merrte zjarr tërë dhoma.

Si u ngrit, Gaqi hapi dritaren dhe mori frymë thellë.

— Bobo, ç'bëmë! — tha.

— More, a shpëtove pa dëm ti!

— Unë po, po rrobat që më hodhe sipër. . .

Tjetri ndjeu atëhere edhe erën e leshit të djegur. E gjeti me mundim shkrepjen dhe ndezi një fije. E rregulloi me nxitim fanarin. Atëhere pa se xhaketa e tij ish djegur mjaft e ish bërë e papërdorshme. Ai e kish bërë zakon që ta vinte mbi karrige nga e prapa, që të mos i ndotej. Kështu e kish lënë edhe këtë mbrëmje. Dhe kur e hodhi mbi shokun që po digjej, xhaketa kish rënë së mbari mbi flakë. Koçua po e shikonte pjesën e djegur të saj. Batanija s'kish pësuar gjë fare.

— Oh, ç'bëra unë! Ty t'u prish xhaketa — thirri Gaqi.

Koçua u kthye nga ai si të kujtohej për diçka me rëndësi.

— Po ti e ke dorën të djegur! — tha dhe ja lidhi me një copë astar prej xhaketes së tij.

Edhe vetë çuditej se si nuk i vinte keq fare që i ish djegur xhaketa, të cilën e kish



dëshiruar aq shumë. Bile ndjehej krenar e i gëzuar!

— Të shkonte shumë. . . Po do të ta jap timen, mos u mërzit! — thesh Gaqi.

Tjetri u kthye nga ai dhe e shikoi me inat.

— Ti e dogje për të më shpëtuar mua — vazhdoi Gaqi — prandaj, unë duhet të ta jap timen.

— Po ma dhe, Gaqi, do ta gris që atë minutë! Unë të shpëtova ty, pa le dhomën e plaçkat, ti akoma flet për xhaketën. E di se tani do më ishe i rjepur e si mos më keq, o shok i dashur?

Si i tha këto fjalë, Koçua e përqafoi shokun e hutuar. Ky qau i mallëngjyer në krahët e tij.

Kështu i gjeti e zonja e shtëpisë që nxitoi tek ata kur dëgjoi zhurmë. Dy ditë më pas, Koçua kish një xhaketë tjetër edhe më të mirë se të parën. Ngjarja e asaj nate e kish forcuar akoma më shumë shoqërinë e shkollarëve të vegjël.

## KORNIZAT

Vitin e ri shkollor Taqua e filloi në klasën e shtatë. Në atë shkollë për të parën herë klasa e shtatë ndahej në dy paralele, prandaj dhoma e mësimit të B-së, ku u regjistrua ai, ish krejt e re. Muret e forta e të rrafshata, dëborë të bardha, dyshemeja bërë me dërrasa të ngushta e të reja, bangot dyvendëshe lyer me bojë të zezë e gri, tryeza e mësuesit, karriga, dollapi i mjeteve e dërrasa e zezë, bile edhe tabela e nderit dhe gazeta e murit ishin fare të reja, atë vit ishin bërë, dhe ndritnin nga pastërtia. Le pastaj portreti i madh i udhëheqësit të dashur, shokut Enver, vënë në një kornizë të bukur me xham!

Cilido nga nxënësit e B-së ndjehej krenar e fliste me mburrje për dhomën e mësimit që kishin.



Një mbasdite, kur sapo mbaruan së lyeri me bojë vaji kafe dritaret dhe derën e klasës, mësuesi kujdestar pat thënë duke shikuar murin e pasmë:

— Atje në mes do të vemë një parullë e do ta mbyllim në xham. Në të dy anët e saj duhet vënë ndonjë pamje e bukur.

Të nesërmen vajzat e klasës suallën një tok pamjesh, me sa dukej të këputura prej revistës «Ylli». Kur ja dhanë mësuesit, këtij iu bë qejfi shumë. I shikoi me kujdes me një shprehje të thellë kënaqësie në fytyrë, pastaj tha me buzë në gaz:

— Vajzat kanë bërë një punë shumë të mirë. Ju lumtë!

Ai veçoi dy nga pamjet dhe i shikoi edhe një herë, duke i mbajtur disi larg prej vetes. Njëra prej tyre tregonte një anije lufte duke lundruar në det të hapur. Në kuvertën e saj një marinar po shikonte me steriogyp. Në tjetrën dukej një vajzë e re fshatare. Ajo mbante fort një thes, i cili po mbushej me grurin që derdhej me rrëmbim nga makina shirëse. Vajzës i qeshte e tërë fytyra duke parë grurin e ri të pastër e të bollshëm. Pamjet ishin me ngjyra dhe dukeshin shumë bukur.

— Këto do të na e zbukurojnë edhe më tepër klasën — tha mësuesi kujdestar — Do t'i vemë në korniza dhe pastaj s'na mbetet veç t'i mbajmë pastër e me kujdes gjithë këto gjëra të mira që kemi këtu — shtoi ai.

Sapo dëgjoi fjalën «korniza», Taqua uli kokën, sepse zemra i rrahu fort dhe gjaku e shpejtoi lëvizjen në tërë trupin e tij, sidomos në atë fytyrën e bukur me ato sy të kaltër e faqet e kuqe që bëheshin me gropa në mes kur qeshte.

Përse u skuq në fytyrë? Përse i rrahu zemra fort? As ai s'e kuptonte mirë këtë gjë. Babai i tij ish marangoz. Edhe ai vetë, Taqua, e kish qejf këtë zanat dhe shpesh punonte me zdruk e me sharrë dhe bënte ndonjë arkë sendurinash a ndonjë gjë tjetër. Një herë ai kish bërë edhe një kornizë, të cilën e kish lyer me bojë dhe e përdornin për të vënë në të fotografi të familjes.

Kur mësuesi foli për kornizat, Taqua për pak sa nuk u hodh e të thosh që t'i bënte ai. Cilido nxënës ish gadi të bënte çdo gjë për klasën. Kështu Taqua u gëzua që iu paraqit rasti për të bërë diçka për klasën



e tij, që e kishin rregulluar aq mirë. Mirëpo atij i kish ardhur turp të çfaqte dëshirën që i pat lindur atë çast. Prandaj ndoshta e kish ulur kokën. Mirë të zotohej, po a mund t'i bënte dot? A mund të bënte ai korniza të tilla që t'u përshtateshin atyre pamjeve të bukura? A mund të bënte ai korniza që të mos binin më poshtë se sendet e tjera të kësaj klase? Sendet e reja e të bukura të klasës, pra, e kishin trëmbur atë. Prandaj, ndoshta rrinte si i hutuar e s'fliste fare.

Kur po delte prej klasës, atij iu duk se mësuesi kujdestar e shikoi me vëmëndje sikur ta pyeste: «Akoma s'po vendos dot?»

Ai u step nga ky vështrim, ndaloi të dera si me mëdyshje, megjithatë doli jashtë duke i hequr këmbët zvarë. Po s'mundi të merrte pjesë në lodrat e gëzimit e shokëve...

Kornizat i ishin futur në kokë e s'e linin të qetë. Ai veç tek ato e kish mëndjen. Më në fund vendosi. E pse të mos e provonte një herë? Fundja, pse të mos i bënte dot? Ai kish bërë korniza dhe dinte si bëheshin. Do të punonte me kujdes, do të zgjidhte një dërrasë të mirë...

U kthye në klasë dhe i tha me turp mësuesit:

— A më lejoni t'i bëj unë kornizat?

Mësuesi e kish shikuar me interesim të madh, kish qeshur e ja kish vënë dorën mbi kokë duke i thënë:

— Në qoftë se i bën vetë, po.

— Vetë do t'i bëj! Nuk i them fare babit!

— Mirë atëhere, bëji!

Mësuesi e kish përgëzuar Taqon dhe djali po fluturonte nga gëzimi që ai ja pranoi mendimin. I mati pamjet dhe doli i gëzuar nga klasa.

\* \* \*

Shumëkush mund të thotë: «E ç'janë dy korniza? Punë e madhe;» Vërtet, nuk janë kushedi çë, po për Taqon, ama, ishin një gjë e madhe. Kurrë s'e kish ndjerë veten ai më të gëzuar e më të shqetësuar se atë ditë! I kishin besuar të bënte dy korniza për klasën e tij të bukur! Mos ju duket gjë e pakët kjo? Pa provoni t'i bëni një herë e pastaj të shihni! Mirëpo a do t'i bënte dot si duhej, ashtu si kish qejf ai? Ja, kjo e shqetësonte.



Sapo hëngri drekë — duhet thënë se ai hëngri me nxitim të madh atë ditë — Taqua vajti në hayat ku punonte shpesh bai i tij.

I ati nuk ish. Ai punonte në stallat e kooperativës dhe kthehej në mbrëmje, po në hayat ndodhej një bango e gjatë. Atje kish edhe dërrasa të ndryshme dhe nga të gjitha veglat që përdorin marangozët.

Taqua zgjodhi një dërrasë të ngushtë prej plepi. Dërrasa ish e re dhe s'kish asnjë gdhë a spicë që të mos punohej mirë.

— Kjo më duhet mua — tha ai — Veç që punohet mirë, po edhe nuk prish kushe-di sa punë, një rryp është. . .

Nxori xhaketën dhe ja filloi punës menjëherë. E mati dërrasën dhe e ndau në mes për së gjati, duke hequr me vizore një vijë të drejtë me atë kalemin e trashë të marangozave. Duhej ta sharronte në mes, që të bënte dy rrypa. Pastaj rrypat do t'i zdrugitte dhe. . .

E shtrëngoi dërrasën e plepit me matkapë<sup>1)</sup> pas bangos që të mos lëvizte, mori

---

1) = vegël marangozi

bracën<sup>1)</sup>) dhe filloi ta sharronte duke i dhënë me forcë poshtë e lart.

Sapo kish filluar punën, kur dëgjoi ta thërresin:

— Taqo! O Taqo!

Pa pritur përgjegje, ai që thërriste e shtyu portën dhe hyri në oborr. Ish Pirrua, një shok i së shtatës A.

— Si është puna? — pyeti Taqua, të cilit s'i erdhi mirë që po e pengonin, aq më tepër se s'desh ta merrnin vesh shokët, veç kur t'i kish mbaruar me sukses.

Pirrua po vinte drejt tij duke shikuar me mospërfillje në bangon e punës.

— Ç'po bën kështu? — pyeti.

Taqua sikur u turpërua.

— Dua të bëj dy korniza — tha.

— E ç'i do këto korniza? Ama mendje! Hajde të vemë nga dyqani se ka ardhur filmi!

— Nuk vij dot, do t'i bëj kornizat!

— Posi, o, posi! Se s'i bën nesër kornizat!

— Për nesër më duhen, pa mirë e ke ti.

---

1) = vegël marangozi



— Po është Skënderi, mor budalla! Ti e di që ai na le ta ndihmojmë për t'i rregulluar aparatet!

Taqua po shikonte si me dy mendje. Pirrua po e nxiste me zell të madh. Aq dëshirë kish ai për ta marrë shokun, sa duke folur i ngërdheshej fytyra plot prenka, nga që desh t'u jepte rëndësi fjalëve e ta bindte.

Taqua e kish qejf filmin, sidomos kish qejf të merrej me aparatin e filmit. Bashkë me Pirron ata ishin bërë si ndihmësit e Skënderit, një djalë i gjatë, që vinte herë pas here me «gaz» për të çfaqur filma në fshat.

Taqua ish në gjendje edhe vetë ta jepte filmin dhe Skënderi i thosh shpesh me shaka:

— Të vjen ndoresh ty, shejtani vete je! Patjetër do të bëhesh operator filmi.

...Dhe tani Pirrua po ja ngacmonte dëshirën.

Por luhatja e Taqos ish shumë e shkur-tër.

— Sot nuk vij dot — tha prerë.

Pirros iu prish qejfi.

— E ç'dreqin i do me kaq ngut këto

korniza? Sikur je marangoz i vërtetë! Ti po lot me to!

Marangozi i vogël e ndjeu veten të fyer.

— Loz thua ti? Unë po bëj korniza që t'i vendosim pamjet në klasë! — tha me mburrje.

Tjetri u habit.

— Ti do t'i bësh kornizat e klasës?! Ç'të paska marrë koka erë!

— Do t'i bëj, ja të shohësh! — tha i vendosur Taqua.

— Do të të ikë kot tërë mbasditja, atë do të bësh ti, kur të them unë. Pa i lerë aty dhe hajde të vemë ku të thashë. Mos u bëj budalla — po mundohej ta bindte Pirrua.

— Nuk vij! Mos u mundo të ma mbushësh mëndjen! E ke kot, shko vetë nga filmi!

Dhe Taqua vazhdoi punën.

Pirrua ndënji edhe një çast. Shikonte se si shoku i tij e punonte me shkathtësi sharrën, e cila nga çasti në çast hynte më thellë duke e ndarë në dy pjesë të barabarta dërrasën e vijosur. Ajo bënte një



zhurmë të vogël, të njëllojtë e të këndshme duke hedhur lart e poshtë tallashin e drurit që binte në tokë si dëborë.

Pirros i pëlqeu kjo punë dhe Taqua iu duk si një usta i vërtetë. Megjithatë, i dukej qesharake ajo që kish marrë përsipër shoku i tij dhe u largua prej andej. Mirëpo sapo doli prej shtëpisë së shokut, e pa se s'kish aspak dëshirë për të vajtur nga dyqani. E tërhiqte më tepër hajati ku punonte Taqua. Sa bukur e priste dërrasën ai! Sa shumë priste ajo braca e tij! Ama, ajo ish sharrë! Me siguri e kish mprehur mirë e mirë babai i Taqos! Kushedi sa kënaqësi ndjente Taqua duke sharruar me të!

Shih, shih, ç'i shkon ndër mend atij Taqos! Të bëjë korniza për klasën! Nuk do t'i bëjë dot! Le që, ehu! Ç'korniza të bukurra duheshin aty! Po sikur t'i bënte? Po sikur? Ai, Pirrua, nuk do të guxojë ta shohë në sy, pastaj!

Pirrua shkante rrugës duke biseduar kështu me vehten e tij. Ca kohë më parë, kur Taqua mburrej për klasën, ai ja kish pritur:

— E mo, ç'na mburresh kaqë! Se mos e bëtë ju! Atë e bëri kooperativa. Është e re, prandaj është më e bukur.

Po këtej e tutje ç'do t'i thuash? Ja, Taqua po bënte diçka për klasën e tij. Ai me të drejtë mund të thosh: «Kooperativa e bëri, po edhe ne s'ndënjëm duar kryq!» Dhe do ta shikonte drejt në sy triumfues.

Kur e përfytyroi këtë vështrim triumfues të shokut, Pirrua uli kokën, se i ardhni turp. Atij i thettri në zemër. Vallë, s'mund të bënin diçka edhe ata për t'ja ndryshuar ca pamjen klasës së tyre? Ja, vajzat ishin vënë në lëvizje: e pastronin mirë, vinin gazeta në dritare. Po Pirrua kish qëndruar fare mënjanë. Sikur të bënte edhe ai dy korniza? Në shtëpi u kishin mbetur ca copa xhamesh kur rregulluan dhomën lart. Ato s'hynin në punë për dritare, se ishin të vogla, po për kornizat bënin me siguri. Ca pamje do të gjenin edhe për ato. Dhe sa do të gëzohej ai mësuesi i tyre, që ish i shkuar nga mosha!

Si mendoj kështu, Pirrua u kthye nga rruga. Tani atij i delte një problem tjetër: Kornizat nuk mund t'i bënte pa ndihmën e Taqos. Taqua me siguri do t'i bënte! A nuk e sharronte dërrasën si usta i vërtetë? Mirëpo ç'iu desh atij, Pirros, t'i thosh gjithë ato fjalë? A do të pranonte Taqua



të bënin edhe dy korniza të tjera pas asaj bisede që kishin bërë pak më parë?

«Sidoqoftë, do të vete një herë! Taqua është shpirtmirë. Ai nuk është cmirzi e patjetër do të më ndihmojë. A nuk më ka ndihmuar kaq herë?» dhe ai kujtoi se si, kur ish i sëmurë, Taqua vinte çdo ditë në shtëpi dhe ja shpjegonte mësimet e ditës, se si një herë, verës, e kish ndihmuar të ngarkonte kalin me dru e sa e sa raste të tjera.

— Taqua është shok i mirë! — tha përsëri ai duke iu ngrohur zemra nga shpresa, pasi kujtoi këto gjëra.

Pas pak, ai ndodhej përsëri pranë marangozit të vogël. Ky kish vajtur deri në mes të dërrasës. Ish skuqur në fytyrë. Po bënte sikur rregullonte matkapin, po dukej që ish lodhur e po pushonte pak.

— Pse s'vajte, apo iku? — pyeti Taqua.

— Jo, mo, aty është, po... nuk desha. A e di, Taço? Më pëlqeu kur punoje ti. A pranon të të ndihmoj edhe unë dhe...?

— Pirrua nuk guxoi ta çfaqte menjëherë dëshirën e tij.

— Mirë, ndihmomë! — tha tjetri i

gëzuar. E drejta edhe atij iu bë qejfi që shoku u kthye. Këtë ju e kuptoni...

— Mbaje dërrasën ti! — urdhëroi «ustai».

— Pse, punën e çirakut do të bëj unë?  
— tha i prekur tjetri. — Më lerë të sharroj!  
— shtoi. — Ke për të parë që edhe unë di!

Tjetri s'pati kundërshtim, veç ndënji pranë tij, se s'kish edhe aq besim.

Pirrua zuri të sharronte. E filloi me rrëmbim e një herë lepitka e sharrës u hepua, ndërsa më pas dredhoi pak nga vija e hequr me kalem, po me ndihmën e shokut shpejt ja mori dorën punës.





Dërrasa u sharrua. Ustai i vogël filloi ta zdrugitë njërën. Këtë punë nuk ja besoi shokut veç kur e provoi me një copë dërrasë të papërdorshme.

Kur dy rrypat e ngushtë e të gjatë ishin rrafshuar e llustruar, Taqua mori një zdrukth me lepitkë të ngushtë vendosur në një të prerë si shkallë. Me këtë bëri paturen.

Edhe këtë punë e bënë për bukuri. Të dy punonin në heshtje, të gëzuar. Shpesh ustai i vogël urdhëronte diçka e tjetri e plotësonte menjëherë këtë urdhër. Për të bërë paturen, ai nuk e lejoi fare shokun, le që edhe Pirrua s'kish qejf, sepse nuk e përdorte dot atë djall zdrukth të çuditshëm që të shpëton nga dora kaq herë.

Pastaj ardhi puna tek prerja e rrypave, sipas masave të pamjeve. Këtu Taqua e pa zor. Nuk i vinin drejt sadoqë i kish prerë me gone. Dërsiu e u shqetësua pa masë. I vinte turp nga vetja e nga shoku. Si? Ta sillnin punën deri në këtë pikë dhe të mos e përfundonin dot? Një herë tha që të vinin atje ku punonte i ati e t'ua bënte ai këtë punë, po shpejt u kujtua se ish zotuar t'i bënte vetë dhe hoqi dorë nga

ky mendim. Vajti në dhomë, mori një kornizë dhe e studjoi me kujdes. As nga kjo s'mësoi dot gjë. Ai zuri t'i vendoste copat e prera si kornizë dhe atëhere e kuptoi: duhej t'i provonte përsëri me gone dhe, atje ku s'vinte mirë, ta hante me skarpele. Kështu bëri. Pirrua ja mbante copat dhe ai i rregullonte. Pas pak korniza e parë ish gati. Taqua e mati edhe njëherë dhe, kur pa se ish tamam, tha si një i madh:

— Njërën e bëmë. Tjetra s'do të na mendojë fare.

Kur u mbarua tjetra, Pirrua tha:

— Unë kam xhama të vegjël që s'na duhen. Do të t'i sjell, po... Taqo, ... sikur të bëjmë edhe dy për klasën tonë? Nuk ta them për xhamat këtë, po kam qejf edhe unë që ta rregullojmë ca klasën. Kushedi sa do të gëzohet mësuesi ynë!

Po, Taqua e kuptonte këtë. Ai ish shumë i gëzuar. Ai ish shumë i kënaqur. Detyrën që i kish vënë vetes dhe që e kish munduar mjaft, tani e kish kryer: kornizat ishin gati. Dhe ishin korniza të bukura, si prej ustai. Kur t'u vihej xha-



mi e të lyheshin me bojë, ato do bëheshin po aq të bukura sa sendet e tjera të klasës së tij. Mësuesi do të kënaqej. Ai e përfytyronte mësuesin e tij duke i shikuar kornizat të mbajtura disi larg vetes e duke buzëqeshur me kënaqësi. Ai e përfytyronte kështu dhe ndjehej i lumtur, i lumtur si asnjëherë tjetër. Pastaj e kish ndihmuar edhe Pirrua. Pirrua ish djalë i mirë. Sa me bujari kish çfaqur ai dëshirën për t'i dhënë xhama!

Taqua qeshi, sepse ish i gëzuar e i lumtur.

— Hajde — tha — merre atë dërrasën aty! Tani ne mund të bëjmë korniza sa të duam! Jemi apo s'jemi ustallarë!

Pasi e shikoi një copë herë duke qeshur, ai shtoi:

— Si të duket ky zanat, Pirro? Mua më pëlqen shumë. S'ka kënaqësi më të madhe se të shohësh dërrasën e zdrugitur e të lëmuar! Apo kur mbërthen me sqepar! Unë e kam vendosur që tani, marangoz do të bëhem kur të dal nga shkolla!

— Ti e ke kollaj — tha Pirrua — Po unë?

— Mjaft që të kesh merak — iu përgjegj tjetri.

## NË VERË

Në pushimet verore djemtë e vegjël të fshatit merreshin me punë të ndryshme. Disa punonin në kooperativë, disa sillnin dru nga mali, të tjerët vinin me bagëti.

Gimi vinte me bagëti. Ish bërë shok me Fevriun e Agronin. Ai merrte lopën e racës, një mëshqerë dhe një lopë vëndi. Po kaq kishin edhe shokët. Së bashku formonin një tufë të vogël prej dhjetë bagëtish, se Agroni kish edhe një mëz, dhe çdo mëngjes, sapo binte dielli, ja merrnin për-pjetë, nga Uji i kripur, ku kish vënde të mira për kullotë.

Dielli ish i nxehtë. Në mëngjes ai e niste me nxitim rrugën e tij të gjatë dhe shpejt e shpejt ngjitej lart në kupën e qi-



ellit, pastaj sikur lodhej, bëhej i vogël, tërë rreze, sa s'e shihje dot, digjte si zjarr dhe dukej sikur s'ecte fare, aq ngadalë shkonte.

Dita dukej e madhe dhe vapa mezi durohej.

Afër drekës, kur vapa shtrëngonte shumë, ata i shpinin bagëtinë buzë lumit. Lopët pinin ujë me etje, rrinin ca brënda në lumë dhe papritur fillonin e kullosnin në bregun e tij, sikur atëhere sapo qenë lëshuar.

Në këtë kohë djemtë laheshin në një pellg aty më lart që i thoshin llomi i Lames. Llomi ish i madh dhe me ujë gjithë të kulluar. Ish një gropë si koritë e formuar në shkëmb, prandaj s'turbullohej kurrë.

Dy prej djemve laheshin, kurse i treti ruante bagëtinë, se aty më poshtë ndodheshin misrat e jonxhat e kooperativës. Dhe lopët, kur shohin gjelbërim, sulen si të tërbuara.

Një ditë i qëlloi Gimit të bënte roje. Ndërsa bagëtia kullosnin, ai po zbukuronte me thikën e xhepit një shkop prej thane që

sapo e kish prerë në koriye. Ish ulur në mezhdën buzë misrit. Bagëtia po kullosnin më lart. Duke kullosur, lopa e racës xhersej, Manushaqja, u afrua deri tek këmbët e Gimit. Ai e la punën dhe po e vërente. Manushaqja e nxirrte gjuhën e saj të madhe si një lopatë, mbledhte barin dhe e gllabëronte me nxitim, sikur e ndiqte ndokush. Nga nxitimi ajo gulçonte, sa mezi mbushej me frymë. Ajo ish pak më e madhe se lopët e vendit. Kokën e kish të vogël e të bukur. Sytë plot gjallëri, ndërsa qimen të kuqëremtë si më të zezë.

Gimi e shikonte dhe kënaqej. Ajo ish një lopë për kokë të lopës. Qumësht kish shumë e të yndyrshëm. Në familjen e tyre të gjithë pinin qumësht në mëngjes, e ëma shpesh tundte e nxirrte gjalpë e gjizë sa u duhej e me gjithatë për ditë shpinin disa litra në baxhon<sup>1)</sup> e shtetit.

Po kish ca ditë që e ëma thosh se Manushaqja e kish pakësuar qumështin, bile edhe të yndyrshëm nuk e kish si më parë. Dhe gjithë në këto raste, i ati fliste

---

1) punishte ku punohet qumështi.



sikur shprehte një gjë të ditur me kohë:

— Bari i korijeve dhe i kodrave mbi fshat nuk ka bulmet shumë, po për të shëndoshur, i shëndosh mirë bagëtinë.

Pas pak, duke shikuar Gimin, ai shtonte:

— Por, po të kullojë mirë, ama, e vë në vënd qumështin e bulmetin si në fushë. Fusha ka bulmet, po s'ka kullotë, lart ka kullotë më mirë, kështu që është njëlloj.

Po pse ai e shihte gjithënjë. Gimin kur i thosh këto fjalë? Gimi e kuptonte këtë si një qortim të bërë me kujdes për mos të fyer. Ai i kuptonte kështu ato fjalë: «Po të kesh merak, i gjen vëndet me bar, ku Manushaqja do të fryhet mirë e mirë e pastaj edhe qumësht do të ketë shumë.»

Kur po e vërente Manushaqen, e cila kulloste mu ndër këmbët e tij, Gimit iu kujtuan këto fjalë të t'et. Lopa e përkëdhelur e ngriti kokën dhe e zgjati muc-kën tek Gimi. Ky ja ledhatoi me duar fytyrën. Rëmoi torbën për t'i dhënë ndo një kafshitë buke, po s'i kish mbetur asnjë thërrime. Atëhere shikoi si fajtor rro-

tull vetes. Ja ku paskej qenë një misërishtë e këputur, fare pranë tij. Gimi ja dha Manushaqes, e cila e përllau me njëherë duke nxjerrë jargë të bardha. Si e mbaroi atë, ajo desh edhe më. Gimi u zu ngushtë. Ç't'i jepte tjetër? Kërkoi me sy ndonjë fije troskë<sup>1)</sup> në misër, po ara ish prashitur mirë e nëpër të s'kish mbirë fare bar. Lopa kërkonte ndonjë gjë për të ngrënë. Kjo dukej në sytë e saj lutës dhe në mënyrën se si e tundte atë kokën e bukur. Gimi e përzuri pak më tej. Po ajo, që e kish kuptuar se djali i kish folur me të keq e që nuk e kish ngarë fare me stap veçsë i kish rënë si për ta ledhatuar, iu kthye prapë. Këtë radhë ajo kërkonte më me ngulm. Dukej që e kish ëmbëlsuar misërishtja e njomë, sepse me kokë bënte nga të tjerat, që ishin më këmbë. Gimi e shikoi. Misërishtet ishin të gjata e sapo kishin prerë kallëp. Disa prej tyre kishin nga dy e nga tre kallëpë.

«Është gjynah t'i këputësh ato» tha me vete djali i vogël. Po sytë i zunë një misërishte shterpë, pastaj edhe një go-

---

1) Lloj bari që rritet në vënde me lagështi.



xhomel. Ai i këputi pa ngurrim ato dhe ja dha Manushaqes. Pastaj këputi edhe ca misërishte të tjera.

«Fundja, ç'do të bëhet për disa misra më pak? Punë e madhe» u përpoq të qetësonte ndërgegjen e tij.

Pas pak vuri re se po vinin shokët dhe e ngau lopën më tej duke i folur rreptë.

Ajo piu ujë përsëri dhe u' bashkua me shoqet.

Gimi shkoi të lahej. Në llomin e pastër e me ujë të bollshëm ai i harroi sakaqherë misërishtet që kish këputur.

Në mbrëmjen e asaj dite e ëma ish kthyer nga ahuri duke mbajtur kusinë plot qumësht me shumë qejf.

Ajo tha:

— Gimi, nga i kullote lopët sot? Manushaqja na e mbushi kusinë, shikoje! — dhe zgjati enën e madhe që dukej si e mbushur me shkumë sapuni.

Djali tha diçka nëpër dhëmbë. Atij i kish bërë përshtypje ndryshimi i menjëhershëm.

«Çudi — mendonte — me t'i dhënë

sot ca misërishte të njoma, e shtoi qumështin!»

Të nesërmen e shpunë përsëri bagëtinë nga uji i kripur dhe në vapë i rrëzuan te lumi. Dhe përsëri, sadoqë kish vendosur të kundërtën, Gimi s'mund të





mos ja plotësonte dëshirën Manushaqes, e cila i vajti pranë dhe sikur i lutej: «A nuk ta shpërbleva mbrëmë? S'të vjen keq? Ja që më hahet!»

Atij vërtet i erdhi keq, shikoi vjedhur andej-këtej dhe prapë këputi disa misërishte të njoma dhe e gostiti lopën me to.

Atij i dukej se kish këputur fare pak dhe as që do të binin në sy në tërë atë misër. Po kur vuri re, u habit: ish boshatisur një goxha vënd! U trëmb. E përzuri lopën prej andej dhe u largua edhe vetë.

Në ditët e mëpasme nuk ndënji më tek mezhda e misrit. Nuk i besonte dot vetes. E dinte që do ta mposhte vështrimi lutës i lopës së tij të përkëdhelur. Por ajo i vajti edhe atje tek mezhda e jonxhës ku po rrinte ai, për të penguar që bagëtia të bënin dëme.

Gimi i dhà një dorë jonxhë, pastaj edhe një tjetër. Jonxha ish më ndryshe. Ajo s'ish bukë. Atë sikur nuk e vriste edhe aq ndërgjegja për ato duar me jonxhë që kish këputur. Ç'do të bëhej për një vëndak jonxhë më pak? Kooperativa kish qindra dynymë!

Duke gjykuar në këtë mënyrë, e du-

ke marrë zemër nga fjalët e prindërve, të cilët e lavdëronin që lopa po u bëhej «fabrikë qumështi», Gimi çdo ditë këpus-te jonxhën e kooperativës dhe ja jepte Manushaqes së tij. Nga dita në ditë kjo filloi t'i dukej një punë e zakonshme, brënda rregullave. Shokëve të tij s'u shkonte kurrë ndër mend se ç'bënte Gimi kur mbetej vetëm pranë jonxhës. Veç kësaj, jonxhën ai s'e këpuste radhazi, e ajo thua jse s'njihej fare që ish tra-zuar.

Një ditë Gimi kish rendur shumë du-ke ndjekur një gjarpër nga ata me helm, që i kish dalë papritur mu para këmbëve.

Në fillim ish trëmbur e ish mbra-psur duke thirrur i llahtaritur. Nepërka e zgjaste kokën e saj trekëndëshe e si të shtypur me ato pullat e verdha anash, e ngrinte lart duke e lëkundur sa andej kë-tej e duke nxjerrë jashtë gjuhën e saj si gërshërë. Gimi ja kish parë edhe sytë, që i kish si dy rruaza të voglia prej qelqi, të vogla e të bardha. Përnjëherësh gjarpri ish kthyer anash dhe kish nxituar të fshi-hej. Gimi e kish mbledhur veten, e kish ndjekur pas dhe mezi e kish vrrarë, sepse



ish vapë dhe nepërka kish shpejtësi të madhe. Pastaj kish psherëtitur i lehtësuar. Dikur gjyshja u pat thënë se, kush vret një gjarpër e ka hallall bukën dhe i zgjattet jeta dyzet ditë, ndërsa kur s'e vret ndodh e kundërta. Ai tani ish rritur dhe e dinte se kjo s'qe gjë, megjithatë i ish bërë zakon që po të shihte gjarpër do ta vriste patjetër.

Deri sa kishin vajtur tek lumi, atij i qe dukur sikur një gjarpër tjetër po lëviste në bar. Ç'është e drejta, ai kish edhe frikë prej tyre. Sapo arritën tek lumi, u xhvesh dhe u fut në ujë. Uji ishte i vaktë, po lumi sillte një fllad të freskët. Ai u la mirë e mirë bashkë me Agronin, pastaj doli, u vesh dhe vajti të zëvendësonte Fevriun. Vetë ndenji, si gjithnjë, tek mezhda. Në çast lopa e ëmbëlsuar çatisi para tij.

Ai e ledhatoi si përherë dhe nxitoi të këpuste ca jonxhë, mbasi e dinte se Agroni do të vinte nga çasti në çast. Këpuste me rrëmbim jonxhë duke e kapur me forcë duar-duar e duke shikuar andej-këtej me frikë. Befas dora i preku diçka dhe ai ndjeu një dhëmbje therrëse në gishtin

e mezit. Menjëherë iu kujtua gjarpëri dhe thirri i llahtarisur.

Aq të freskët e kish në kujtesë vrasjen e asaj nepërkës së helmuar, sa iu duk sikur e pa të mbërthyer pas gishtit të tij. Atë çast ish i sigurt se ja kish dalluar edhe trupin lara-lara. I trembur sa s'behej më, thërriste e lebetitej.

Kur arritën shokët, atë e gjetën dyllë të verdhë në fytyrë dhe të mbuluar nga djersët. Po hiqte duke shtrembëruar fytyrën një gjemb të madh që i kish hyrë në gisht.

— Gimi, ç'ke Gimi? — pyeti i trembur Agroni.

Fevriu shikonte i habitur dhe priti edhe ai përgjigjen. Gimi tha i turpëruar.

— Më hyri ky djall gjemb në gisht e m'u duk sikur më kafshoi nepërka.

Ai po e vërente gjëmbin. Ish një gjëmb i gjatë e i fortë prej murrize. Kish qënë në jonxhë bashkë me një degë, e cila vende-vende kish zënë myshk të bardhë. Dega me gjëmba e murrizës ish e shtrënguar në tokë. Kur ai i dha dorës me forcë, njëri nga gjëmbat e saj i qe futur thellë në gisht. Po gjëmbi nuk ish shkë-



putur nga dega, e cila qe varur pas dorës së djalit dhe i qe dukur si gjarpër.

Gimi po e vështronte këtë degë duke buzëqeshur nga zori. Pastaj shikoi gishtin që i ish skuqur nga gjaku. Ai po kërkonte ndonjë leckë që ta lidhte, po Agroni e ndali:

— Le të rrjedhë ca gjak, kështu ësh-të më mirë, se s'ka rrezik për tetanoz.

Më pas ai kish pyetur:

— Po ç'deshe këtu në mes të jonxhës? Ç'e ke këputur këtë jonxhë?

Po kur hodhën sytë më poshtë, në një vend si të fshehur buzë lumit, dy shokët e Gimit panë Manushaqen e tij që po hante me lakmi jonxhën e porsakëputur.

Ata u shikuan sy ndër sy të habitur nga ky zbulim i befasishëm.

Gimi e kuptoi, u skuq e uli kokën. Agroni rendi tek Manushaqja, ja rrëmbeu jonxhën që ajo s'kish mundur ta hante, e përzuri atë tek bagëtitë e tjera dhe u kthye tek shokët duke shtrënguar dhembët nga inati.

— Të tilla punë bën ti? Turp të kesh! Hajdut! — tha me përbuzje.

— Prandaj na lëvdohet se Manu-

shaqja e ka shtuar shumë qumështin! E ushqeka me jonxhën e kooperativës, i dituri! Që kur na e paske mësuar këtë zanat?

Gimi shtrembëroi fytyrën dhe shtrëngoi gishtin duke lënë të kuptohej se i dhimbte shumë.

— Kur të qenka mësuar për të vjedhur, më mirë të ta kish kafshuar nëpërka atë dorë! — tha Agroni përsëri me përbuzje.

Gimi ngriti kokën. Në syt' e tij dukej një keqardhje e thellë. Buzën e kish gati në të qarë. Ja, deri ku arrinin shokët e tij! S'u vinte keq për të dhe thoshin se do të qe më mirë ta kish kafshuar gjarpëri! Në fillim, as ai vetë nuk e mori vesh ç'ndjeu kur i dëgjoi të flisnin në këtë mënyrë. Ish tronditur e turbulluar e s'fliste dot.

Fjalët e shokëve e bënë ta kuptonte fajin që kish bërë. Qëllon që mësohesh me një veprim të keq, po, sapo sheh sa keq e çmojnë shokët, vetë e kupton të vërtetën dhe atëhere, sikur ta shohësh për të parën herë, ve re se vërtet ky veprim



është i ndotur, i shëmtuar dhe të vjen turp, shumë turp.

Këtë po provonte tani Gimi kur rrinte kokulur para shokëve të tij.

— Mua më tha rojtësi i kooperativës se kemi bërë dëm këtej, po unë s'e pranova. Dhe isha i bindur, mirëpo... — tha Fevriu.

— Që sot do të ndahemi prej tij! Nuk e kemi më, shok atë! — tha Agroni — Do t'u them të gjithëve në fshat ç'ka bërë — shtoi ai.

Gimi u drodh nga këto fjalë.

E humbi durimin, shtrëngoi grushtat gati për t'u zënë me shokët, pastaj u pendua, kafshoi buzët me inat dhe mbeti si i ngrirë, pa ditur ç'të bëjë.

...Shokët e tij po e mblidhnin bagëtinë për t'i dhënë udhën e fshatit. Në fillim lopët lakmitare sulmonin herë nga misri e herë nga jonxha, po, si e panë se s'delte gjë nga këto sulme, e shtruan mëndjen dhe u nisën të bindura drejt rrugës. Pas tyre ngrihej një re e vogël pluhuri, e cila shpejt humbiste duke u shkrirë me ajrin e vaktë nën qiellin e kuqëremtë.

Të tre shkonin në heshtje. Kjo hesh-

tje ish e rëndë dhe sa vinte bëhej e padurueshme për Gimin. Ai e përfytyronte veten të ndarë prej shokëve dhe ndjente dhëmbje në zëmër. Edhe disa minuta i mbeteshin për të qënë me ta. Të nesërmen ata do të bëheshin si të huaj për të. Do t'i mbanin bagëtinë larg tij dhe, kushedi, kur të takoheshin ndonjëherë rastësisht, ndoshta nuk do t'i flisnin fare, ndoshta edhe nuk do të kishin dëshirë as për ta parë, si në këto çaste kur asnjëri prej tyre s'i hidhte qoftë edhe një vështrim përbuzës. A e merrni me mend sa e vështirë është të ndahesh nga shokët kur ti i do, por ata s'të duan? A e përfytyroni dot dhëmbjen që ndjen njeriu kur e detyrojnë të prishet me një shoqëri që s'i është mërzitur aspak?

E ndjen veten të fyer rëndë, të poshtëruar si mos më keq, jeta të duket si tallje; nuk e do veten. Dhe mbi të gjitha, të përfytyrosh se në fshat të tërë do të të marrin nëpër gojë për keq, do të të tregojnë me gisht e do të thonë me përçmim: «Ja ai!» Po nëna, babai? Kushedi sa do ta qortonin ata!...

Gimi u shkund dhe ktheu kokën anash, se s'desh të kish akoma para syve një pam-



je kaq të përzishme. Atë çast rruga ku po kalonin qëlloi e ngushtë dhe ai u afrua me shokët e tij. Duke iu dridhur zëri nga tronditja, me sy të zgurdulluar nga vuajtja shpirtërore mezi mundi të thotë:

— Agron... Fevri... shokë!

Ata u ndalën dhe e shikuan me zemërim po dhe keqardhje. Këto fjalë ishin shqiptuar në një mënyrë aq ngjethëse sa që nuk ish e mundur të mos ua vinin veshin.

Agroni e shikoi me vërejtje shokun e penduar dhe tha me seriozitet të madh:

— Shiko, veçse po e përsërite më!...

— Ta përsërit? Unë ta përsërit? Ju betohem se...

— S'është nevoja të na betohesh. Ne të besojmë...

Megjithse e kishin falur, Gimi prapë e kaloi në heshtje rrugën që u mbetj gjer në fshat. Biseda e asaj dite s'kish gjallëri. Atij i pëlqente heshtja. Kur e kur godiste me shkop ndonjë gur e ferrë si një njeri që s'di ç'të bëjë.

Kur zhdukej pluhuri i rrugës, nga lindja shikonte qiellin e kaltër, që rrëzë maleve dukej sikur kish marrë flakë.

Manushaqen do ta kulloste mirë edhe  
më pas, por kurrë, kurrë nuk do të këpuste  
qoftë edhe një fije bari në arat e koopera-  
tivës! Kini për ta parë se ai do ta mbajë  
fjalën!



## NDËRGJEGJJA

**N**xënësit u ulën në vendet e tyre. Asnjë lëvizje, asnjë zhurmë s'u ndje më. Të gjithë ja kishin mbërthyer sytë mësuesit dhe prisnin ç'do të thosh ai. Shiknin herë atë, herë togun e fletoreve, që ai i kish lënë mbi tavolinë, herë duart e tij. Cilën fletore do të merrte të parën? Ç'notë do të kish marrë? Këto pyetje bënte me vete secili nxënës.

Vetëm dy vajza, Liliana dhe Tefta, rrinin kokulur. Shpesh shihnin edhe ato kureshtare si të tjerët, po, sapo hasnin vështrimin e mësuesit, ulnin kokën e bënin sikur merreshin me diçka atje, në bangën e tyre.

Më në fund mësuesi mbaroi me vërejtjet e përgjithshme. Si përmendi disa nga ata që e kishin bërë detyrën më mirë, ai i ndau fletoret. Secili e hapte si me droj-

tje e me nxitim, shihte notën dhe nga shprehja e fytyrës kuptohej në kish marrë notë të mirë a të keqe.

Liliana e la të hapur fletoren sipër bangës, ndërsa shoqja e saj, sa e pa notën, e mbylli me të shpejtë dhe e futi përposh.

Nxënësit kureshtarë, si u siguruan për vete, zunë të interesoheshin për të tjerët, siç e kanë zakon. Me zë të ulët e me shenja pyesnin më të majtë e më të djathtë.

— Liliana, ç'të ka vënë ty?

— Dhjetë.

— Po ty, Tefta?

Tefta u skuq edhe më tepër se ç'ish skuqur kur pa fletoren dhe mezi tha nëpër dhëmbë se edhe ajo kish marrë dhjetë.

— Dhjetë?! — u habit ai që pyeti — Gënjen! Pa dale ta shoh!

Vajza nuk ja dha fletoren po, kur u bënë edhe ca të tjerë kureshtarë për notën e saj, ajo, flakë e kuqe në fytyrë, e çfletoi fletoren dhe ua tregoi.

Kish marrë vërtet dhjetë dhe shokët e shoqet e saj po habiteshin.

— Mos bëni zhurmë! Secili të shohë



fletoren e tij dhe, po të ketë ndonjë gjë të pa qartë, të më thotë t'ja sqaroj! — tha mësuesi.

Fjalët e tij vendosën përsëri qetësinë. Kokat e nxënësve të heshtur u ulën mbi fletoret e tyre. Vështronin shënimet e mësuesit, vijat e kuqe që kish hequr ai. Ndonjëri thosh me vete: «Ah, si më ka shpëtuar ky gabim i vogël! Do ta kisha dhjetë me siguri!» Një tjetrit i vinte inat që s'ish kujtuar më parë, po si e kish dorëzuar detyrën, për një rast që tani e kish të shënuar me vijë të kuqe.

Lilianës iu duk sikur mësuesi e ndali vështrimin tek banga e tyre. Kështu iu duk edhe Teftës. Po ai kaloi më tej dhe ato shikuan fletoret e tyre. I kishin zgjidhur drejt detyrat, kishin shkruar bukur e pastër dhe, veç dhjetës, mësuesi kish shkruar: «Shumë mirë! Kështu të vazhdosh!» Një detyrë shumë e mirë, një notë shumë e mirë, një shënim i tillë nga mësuesi — e ç'do më tepër nxënësi? Këto janë mjaft që ai të ndjehet i gëzuar e i kënaqur sa më s'ka.

Po ato të dyja nuk ndjeheshin të kënaqura e të gëzuara, përkundrazi, ishin të shqetësuara. Pse ishin të shqetësuara? Pse

të mos gëzoheshin që i kishin bërë aq mirë detyrat! Pse të mos ishin të kënaqura kur mësuesi u kish vënë notë shumë të mirë?

— Secila mendonte me vete.

Lilianës i ish dukur sikur mësuesi kish shikuar me vemendje në bangën e tyre edhe kur bënë detyrën, edhe tani kur ua shpërndau fletoret. Pse kish shikuar ai në atë mënyrë? Asaj i kujtohej se si mësuesi, pasi kish dhënë udhëzime si ta bënin detyrën, kish shtuar:

— Mos e kini mendjen të kopjoni. Kopjimi është një lloj si vjedhja e mos harroni se faji është i njëjtë si për atë që vjedh edhe për atë që e ndihmon të vjedhë. Po unë nuk besoj që ndonjëri prej jush ta ulë veten kaq shumë. Kjo s'i ka hie nxënësit të shkollës sonë.

Kështu kish thënë mësuesi! Lilianës i pëlqyen shumë këto fjalë. Ajo ish e sigurt në punën e saj. Kish mësuar mirë vazhdimisht.

Sa mbaroi mësuesi, ajo uli kokën e filloi të zgjidhte me kujdes detyrën. Mirëpo pas pak, ndjeu se shoqja po i binte me bryl.

— Liliana, tregoma një çikë këtë ush-





trimin e parë, se s'më kujtohet — i tha kjo me zë të ulët, duke shikuar nga mësuesi.

— Jo — iu përgjegj Liliana — nuk bën! S'e dëgjove si tha mësuesi?

Dhe vazhdoi punën e saj! Po shoqja s'i ndahej.

— Liliana, Liliana! Aman, moj, nuk do të më thuash gjëkafshë?

Liliana nuk i përgjegj. Po ja, shoqja e saj i zgjati një copë letër. Ajo lexoi në të: «Kam hall se do të më marrë me sy të keq mësuesi, moj Liliana. Dhe ti e di

se po të mori për keq që në fillim. . Pse bëhesh kaq e keqe? Ja që s'më kujtohet. Tjetër herë s'të mërzit, jo. Kaq zemërgure je?»

Këto fjalë e lëkundën qëndrimin e nxënëses së mirë. Ndoshta shoqes nuk i kujtoheshin vërtet. E po të merrte notë të keqe? Do t'i thosh mendjemadhe, zemërgure. I erdhi keq për shoqen e saj, që tani s'dinte ç'të bënte. Po iu kujtuan edhe fjalët e mësuesit.

«Jo, tha me vete, s'është ndihmë e mirë kjo!» E megjithatë, megjithatë... — ja shkroi në atë copë letër zgjidhjen e ushtrimit. I shkroi edhe një tjetër më pas. Në pushimin e madh, Tefta e kish puthur, i kish thënë se do ta desh më shumë se veten.

Po Lilianën e brente ndërgjegjja kur kujtonte se kish bërë një punë të keqe. Ajo kish bërë një gjë të ndaluar. Jo, kështu s'ndihmohej shoqja! Ajo e dinte këtë e prapë e kish bërë atë veprim që mësuesi e kish krahasuar me vjedhjen. E ku i kish shkuar ndër mend një krahasim i tillë atij, mësuesit? Tani ajo e shihte veten si ndihmëse të një hajduti. Po, e kish



ndihmuar shoqen për të kopjuar! Pse e kish bërë këtë? Pse të mos e mbante veten, po ish prekur aq shumë nga fjalët e Tef-tës dhe menjëherë ja kish treguar ushtri-min? I pat thënë më pas kësaj:

«Tefta, s'bëmë mirë. Mua më vret shumë ndërgjegjja. Të kujtohen fjalët e mësuesit? Mua s'më hiqen nga mendja!»  
Po Tefta ja kish kthyer:

«Përse bëhesh merak, budallaçkë! Se mos e mori vesh mësuesi! E ku na njih ai ne?»

Kështu kish thënë Tefta. Po puna s'ish kaq e thjeshtë. Mësuesi shumë herë bën sikur s'merr vesh nga këto çjera. Ja përse i kish shikuar me aq vërejtje ato të dyja! Pastaj edhe sikur të mos i kish pikasur ai. Po nxënësit? Pse u habitën ata me dhjetën e Teftës? Ata e dinë që Tefta s'është e dhjetës. Më në fund, a nuk e dinte ajo vetë se kish bërë një punë të keqe? A mund t'ja fshehesh dot vetes sate? Sa më shumë të mundohesh ta harrosh një veprim të keq që ke bërë, aq më i freskët të rri në mendje, aq më shumë të kujtohet. Kështu po i ndodhte Lilianës.

Ja, edhe Tefta ish bërë flakë e kuqe në fytyrë dhe kish turp ta tregonte notën

e saj. Pse kish turp? Sepse e dinte që nuk e kish të sajën. E dinte që e kish të vjedhur. Oh, sa keq kish vepruar ajo! Lili-ana, qëkur nuk ish ndodhur në një gjendje kaq të vështirë! Si të bënte? Si ta lan-te këtë njollë që i kish vënë ndërgjegjes? Si të bënte, si?

I kish vënë duart në tëmtha dhe s'shikonte në asnjë anë. I vinte turp. I dukej sikur tërë e dinin ç'kish bërë e ç'mendonte ajo. Dhe s'e ngrinte dot kokën. Djersë të ftohtë i rridhnin nga balli e po ja mbulonin fytyrën.

— Ç'rri kështu, moj Liliana? — e pyeti, shoqja e bangës.

— Më ler rehat! — i tha ajo me inat.

Tjetra e kuptoi. Edhe ajo po mundahej me veten e saj. Si shigjeta që shpojnë në tej për tej i dukeshin asaj vështrimet e mësuesit. Të tilla i kish ndjerë edhe shikimet kureshtare të nxënësve të habitur me notën e saj. Ah, sa të rrepta i qenë dukur këto vështrime! E pse e ngacmonin? Pse s'e linin rehat? Ç'u duhej atyre nota e saj? Po ajo dhjeta e detyrës? Ah, dhjeta! Në fillim, kur e pa, sa s'fluturoi nga gëzimi. Pastaj u turpërua dhe e mbylli fletoren. Dhjeta iu duk e rëndë, e rëndë.



Këtë peshë ajo nuk e mbante dot. E pse i kish vënë dhjetë mësuesi? Ah, budallaçka! Më mirë të kish lënë pa zgjidhur një ushtrim. Kështu do të qe shumë më mirë. E ç'i duhej dhjeta asaj? Ajo ish e bindur që detyrën e kish bërë për notë kaluese dhe, po të merrte gjashtë ose shtatë do të ish e kënaqur e s'do t'i bënte fare përshtypje që kish kopjuar. Po dhjeta, oh, dhjeta ish një notë që ajo s'e kish ëndërruar e jo ta shpresonte. Dhe tani, që e kish marrë këtë notë të shkëlqyer, e ndjente tërë turpin e kopjimit. Tani i dukej sikur këtë notë e kish vjedhur bashkë me fletoren. Se iu duk kështu e se i ardhi turp, prandaj e futi atë me nxitim nën bangë.

Ajo shikoi me bisht të syrit shoqen e saj që akoma s'po e merrte veten. Tefta s'e kish zakon t'i thëllonte shumë punët dhe tronditja kaq e madhe e Lilianës po e habiste.

Atë çast mësuesi u ndal para tyre. Ai e shikoi drejt në sy Teftën. Kjo filloi të dridhej dhe u hutua, po mësuesi e hoqi vështrimin prej saj dhe e hodhi tek Liliana. Ja vuri dorën mbi kokë dhe i tha me zë të butë:

— Si e ke punën, Liliana? S'je e kënaqur me notën? — dhe duke qeshur ai e mori në dorë fletoren e hapur të nxënëses, ku dhjeta binte në sy që larg.

Liliana u ngrit më këmbë. Zemra i rrihte si e zogut kur e zënë në grackë.

— Jo, profesor — tha pa ngritur kokën...

Sa u mat t'ja thosh të vërtetën, kur mësuesi nxitoi me një pyetje tjetër:

— Mos je e sëmurë?

Ajo e gëlltiti me zor të vërtetën që e mundonte dhe pohoi se nuk e ndjente veten mirë. Mësuesi i tha të dilte e të freskohej ca te çezma. E dërgoi me të edhe Teftën.

Kur dualën jashtë, Liliana e ndjeu veten edhe më keq. Ja, padashur, ish bërë edhe gënjeshtare. I kish thënë mësuesit se nuk e ndjente veten mirë, kurse... Edhe këtë e kish bërë! Vërtet s'e kish për gjë tani të thosh ç'i delte nga goja? Po sikur mësuesi ta kish kuptuar? Edhe kjo duhej.

Kishin arritur tek çezma. Ujët e saj të kulluar rridhte i qetë duke kënduar. Postafi ish mbushur plot e prej tij uji



binte poshtë duke formuar kështu dy çezma. Dhe secila kish këngën e saj, një këngë të ëmbël, të njëllojtë, që prishte qetësinë e atij vendi.

Liliana i futi duart në ujë dhe, duke e lloçoçitur atë, ndjeu një freski e kënaqësi të madhe.

Përnjëherësh ngriti kokën.

— Do t'i them, Tefta! — tha në mënyrë të prerë.

— Jo! — kundërshtoi kjo.

— Kot që ta mbajmë fshehur. Ai e di.

— Ku e di ti?

— Duket ajo. Nuk e vë re se si na shikon?

— E pse na vuri dhjeta atëhere?

— Pse? Ku e di unë? Ndoshta që ta ndjejmë edhe më shumë gabimin.

Tefta pohoi me kokë dhe kafshoi buzën. Po, ajo e kish ndjerë më tepër gabimin me atë dhjetën që i kish vënë mësuasi. Mirëpo nuk ja merrte kurrë mendja që ai do ta bënte këtë me qëllim.

Tani, kur po e shikonte sa e shqetësuar ish shoqja e saj, Teftës i erdhi keq për të. Pse të rrinte kështu e merakosur

Liliana? Ajo ish nxënëse shumë e mirë. Në çdo mësim ajo ish e gatshme të përgjegjej. Dhe tani? Për hatrin e saj, të Teftës, atë e vriste ndërgjegja sa s'i rrihej në vend. Po të mos ja kish treguar ushtrimet Teftës, ajo do të qe shumë e kënaqur me dhjetën që kish marrë, kurse tani...

Tefta u skuq në fytyrë nga këto mendime. E ndjeu se ish fajtorë kundrejt saj. Ç't'i thosh? Si t'ja kthente gëzimin e kënaqësinë që ja kish rrëmbyer shoqes së saj? Si?

Po Liljana qe vajzë shpirtmadhe. Ajo kish vendosur:

— Duhet t'i thuash edhe ti, Teftë. T'i themi të dyja. T'ja themi hapur të vërtetën. Ti duhet t'u vihesh më tepër mësimëve. Unë do të të ndihmoj më shumë, po kështu të mos e bëjmë më. Mirë? — i tha ajo.

— Mirë! — pranoi Tefta.

— Më duket sikur kam vjedhur, vërtet.

— Edhe mua... Liliana... Më fal Lili! Unë të vura në telashe edhe ty. Për shkakun tim po vuan ti. Unë...

Tjetra e shikoi me interesim. Pastaj



e hoqi për dore tek çezma. U lanë e u freskuan, pinë ujë dhe u kthyen në klasë. Vendimi që kishin marrë, u jepte guxim e ua lehtësonte ndërgjegjen.

Në klasë kish filluar mësimi. Kur e pyeti mësuesi, Liliana u përgjegj se ndjehej fare mirë. Ai u tha të ulëshin dhe vazhdoi shpjegimin.

Si mbaroi mësimi, nxënësit dualën jashtë. Liliana dhe Tefta mbetën më prapa e s'po u shtyheshin këmbët.

— Kini për të më thënë gjë? — i pyeti mësuesi.

— Po — tha Liliana. — Unë s'isha aspak e sëmurë, unë...

Kokulur dhe herë-herë duke iu dredhur zëri, ja tregoi të vërtetën.

— Po ajo s'ka faj, jo, s'ka faj. Unë s'e lija rehat dhe...

Ndërhyri Tefta.

— E dija që kështu do të ndodhte — tha mësuesi me buzën në gaz — Ju lumtë! Tani e tutje jam i bindur se Tefta do të arrijë të marrë dhjeta të vërteta, ndërsa ti Liliana, po se po — dhe përsëri, duke qeshur e duke vështruar vajzat e pen-duara, doli nga klasa.

Pas tij dualën edhe nxënësit. Liliana ish e gëzuar. Ajo e kish shlyer me sinqeritetin e saj gabimin që kish bërë. Ndërsa Tefta dukej e menduar. Ajo mendonte rastin në të cilin s'kish vepruar si nxënëse e vërtetë. Nga ky kujtim jo i këndshëm faqet e njoma i kuqeshin e i zverdheshin nga çasti në çast. Disa herë ment ja shkrepiti të qarit. Pastaj e ndjeu se tani po, kish hyrë në një rrugë të re, të drejtë, e se rastet e tjera të tilla nuk do të përsëritejshin kurrë më. Asaj mezi i pritej sa t'i vinte në jetë ato që po mendonte në ato minuta të një pendese të thellë.



## MBURRAVECI

**A**kini njohur ndonjë fëmijë që të rrijë gjithë i krekosur para shokëve e të mburret për çdo gjë? I tillë ish Alberti. Ish ky një djalosh fytyrërrumbullak e faqekuq. Hundën e kish me majë e si të kthyer përpjetë. Flokët i mbante të gjatë e të krehur. Edhe për të veshur binte në sy ndër të tjerët. Më tepër i pëlqenin një palë pantallona të shkurtëra që s'kishin nevojë as për rryp e as për tiranda, se kishin një copë llastike prapa, qepur që brennda. Të tilla pantallona nuk kish asnjë tjetër. Ndoshta prandaj atij i pëlqenin kaq shumë ato, se gjithë desh diçka që s'e kishin të tjerët.

Kur rrinte ndonjëherë si kapedan, dukej sikur u thosh shokëve:

«Ja, gjene, po deshët, bëni dhe ju një palë pantallona të tilla!

Dhe fytyra e sytë i qeshnin nga kënaqësia. Do të thoni ju se cilido mund të bënte një palë pantallona si të Albertit. Vërtet, vërtet, po e dini si e pësoi Taqua që guxoi ta provonte? Sapo ja pa mbathur, Alberti e thirri mënjanë dhe i tha se po t'ja vishte tjetër herë, mos i dilte përpara pastaj!

Merreni me mend sa u dëshpërua Taqua i gjorë, i cili mezi e kish pritur këtë rast, se mendja i thosh që Alberti do ta desh e do ta çmonte veç shokëve! I mori inat ato pantallona që, ndryshe nga sa kish shpresuar ai, po e prishnin me shokun më të fortë. Ai nuk i mbathi më ato, duke gjetur shkak se s'i pëlqenin, mbasi i kish ndotur keq me bojë.

Merret me mend që Alberti mbahej si komandant i djemve të mëhallës. Ishte më i madhi nga trupi, vishej më mirë dhe bënte çmos që të ish më i shquar se të tjerët edhe në mësim. Vetëm Qenami ja kish njohur mirë të metat. Ai s'ja kish për pesë e ja kthente fjalën. Ky ish një djalë i shkathët e i fortë. Atij nuk i trembej syri kurrë. Ish më guximtari i shokëve. Ai tallej shpesh me mburrjet e Alber-



tit, po asnjë s'e pasonte nga frika e këtij.

Sa herë që ndonjë nga shokët nuk e bënte dot atë që bënte Alberti, ky thosh:

— S'duhet veç të duash, or jo! Duhet edhe ta kesh në thua, të jesh i zoti prej natyre. Kështu thotë babai im.

Me këto fjalë linte të kuptohej se ai, Alberti, e kish zotësinë prej natyre dhe ish e kotë të mateshin me të.

Mirëpo në këto raste Qenami, ai zev-zeku, siç i thosh Alberti, ja priste:

— Domethënë ai babai yt ka qenë kështu si është, dhe nga jeta s'ka fituar hiç gjë! Ama, ç'na thënke! Mos vazhdo shkollën ti, p.sh., mos mëso, pa të shohësh sa do të dish, sa do ta kesh në thua!

Alberti skuqej nga inati, po nuk desh ta prishte fare punën me këtë djalë të çuditshëm që s'i trembej syri kurrë.

— Pse, ti di më shumë se babai im, a? — i përgjegjej.

— Mos na e hidh gjetkë tani! Kur s'të del mbarë muhabeti, ti nxjerr babanë. Po mësuesin e ke dëgjuar si thotë?

Dhe që këtu vazhdonte një bisedim i zjarrtë, i cili mbaronte ose duke iu kanosur me grushta Alberti Qenamit, ose

duke u ndarë të zemëruar. Qenami mendohej e mendohej më pas se si të ndreqej kjo puna e Albertit. A t'i thosh ndonjërit prej mësuesve? Të bënin një mbledhje të klasës? Mirë do të ish të vepronte në këtë mënyrë. Ndryshe shoku po shkonte tej e më tej në rrugën e gabuar dhe po i tërhiqte edhe të tjerët. Por pas pak nxirrte anën e kundërt të këtij veprimi. Po t'i thosh mësuesit, Alberti do ta tallte duke thënë që s'kish ç'i bënte kalit dhe i binte samarit. Pastaj ata shokët e tij, që u kish futur lepurin në bark Alberti, a do të guxonin të flisnin keq kundrejt këtij në mbledhjen e klasës? Kjo e mundonte shumë atë. Kish vënë re se, kur hahej me fjalë ai me Albertin, të tjerët s'thoshin as mirë e as keq. Kur desh ndonjëri të ndërhynte, Alberti ja tregonte vendin. Ndoshta me mend ata i jepnin të drejtë Qenamit, po «komandantit» s'ja prishnin dot. Veç kësaj, kush e di ç'u thosh ai atyre!

... Thuajse çdo ditë djemtë e mëhallës e kalonin mbas ditën nga Bregu duke luajtur. Qenami bashkohej me ta pasi kish mësuar e i kish bërë detyrat.

— Ç'ja vini veshin atij! — tallej Al-



berti. — Ai u shuajt mbi libra sikur do të fitojë dynjanë. Të mësoja si ai unë! Fundja, si me dhjeta, si me pesa, a nuk kalohet klasa?

Kështu thosh ai. Kur ndonjeri nga djemtë kujtohej për mësimet, «komandanti», i thosh:

— E mo, zure të dridhesh ti, o? E ç'do të na bëjnë, po të mos dijmë të gjithë? Fundja, s'do të bëhemi profesorë ne, de? Po shko, shko, zerja vendin Qenamit, se ai e la tani!...

Dhe qeshte e tallej. Mirëpo, kur në ndonjë nga këto të nesërmen ngrihej në mësim vetë ai, përgjegjej shumë mirë. Ndërsa mësuesi i vinte notën në librezë, ai i shikonte shokët sikur desh t'u thotë:

«E, s'ju kam thënë unë se duhet ta kesh në thua? Ja, veç me shpjegimin e mësuesit jam, hiç s'e kam hapur librin, megjithatë...» Dhe tregonte me kokë regjistrin ku sapo ish shënuar dhjeta.

Po e vërteta s'ish siç thosh ai. Një mbrëmje Qenami me Taqon kishin vajtur tek një kushëri i këtij të fundit. Aty u vonuan mjaft. Duke u kthyer, kur shkuan para shtëpisë së Albertit, vunë re se në

një dhomë kish dritë. Të dy shokët ndaluan e po shikonin në atë dhomë.

— Këtu fle Alberti? — pyeti Qenami.

— Ja, s'e shikon, a? — dhe Taqua i tregoi me gisht perden nëpërmjet së cilës shquhej koka e Albertit.

— Ai po rri në një vend. Ç'bën vallë? Më duket se është në tavolinë.

— Po, atje është.

— Ai mëson, me siguri po mëson!

— S'është e mundur! — kundërshtoi Taqua. — A nuk e dëgjove kur tha se nuk do të zinte libër me dorë sonte? Bile na porositi edhe ne.

Tjetri diçka mendonte e u duk se s'ua vuri veshin këtyre fjalëve.

— Ashtu tha, po... ta shikojmë! — dhe i tha Taqos të ulte kurrizin që të hipete mbi të e të shihte më mirë.

— Bobo! Po sikur të na diktojë? Jo, më mirë...

— Ikë, ore, frikacak! Po dridhesh si pulë. E pastaj, çfarë?

Taqua nuk dinte si të bënte. Nuk desh edhe ta quanin frikacak. Pranoi. E provuan. Po s'arrinin dot. Le që s'i linte perdja.



— Njëqoftëse hipim në atë pemën aty, shohim prej dritares tjetër. Ajo s'është e zënë me perde.

— Vërtet, mirë e ke.

Pas pak i ishin ngjitur pemës. Që atje dukej fare mirë. Alberti ish kërrusur mbi një libër e po lexonte. Dy shokët shikuan njeri-tjetrin në heshtje. Ndenjën një copë herë për të parë në se lexonte vërtet «komandanti». Disa minuta më pas ky e mbylli atë libër. Gërmat e kapakut dukeshin qartë.

— Mësuaka historinë! — tha njeri.

Alberti e la atë libër dhe mori një tjetër. Pastaj u ngrit dhe u shtriq duke shikuar nga dritarja.

— Na pa! — tha Taqua e zuri të zbriste.

— Mos lëviz! — urdhëroi tjetri — Nuk mund të shohësh natën nga brenda jashtë kur në dhomë ka dritë.

Ndenjën e shikuan. Alberti duket ish lodhur në tavolinë. Ai u shtri në krevat dhe atje vazhdoi të lexonte librin tjetër, gjeografinë.

— E sheh, Taqo? Dhe pastaj kreket se e ka në thua! Ja ç'na qenka! — tha Qenami.

Taqua pohoi me kokë. Dukej krejt i hutuar nga ky zbulim i papritur.

— Mburraveci! Nesër të më shohë!  
— thosh duke ikur nxënësi guximtar.

Të nesërmen ndodhi si shumë herë të tjera. Mësuesi i historisë e ngriti në mësim Petritin. Ky kish qenë nga Bregu gjersa u err dhe mësimin s'e dinte. Mësuesi ngriti një tjetër. Ky ish Alberti. Alberti e tha mësimin shumë mirë.

— Bravo, Albert! Dhjetë! Ti, Petrit, nuk je shok me Albertin? Nxënësi pohoi me kokë.

— Ju jeni dhe shokë, edhe fqinjë. A nuk mësoni bashkë? Pse ti nuk e ndjek shembullin e tij?

Alberti bënte sikur s'i dëgjonte këto lëvdata të mësuesit. Ai shikonte krenar, si gjithnjë, nga shokët e tij. Në vështrimin e tij, Qenami lexoi: «E kam thënë unë, bre, duhet ta kesh prej natyre!» Nga kjo i hipi gjaku në kokë dhe për pak u ngrit të thosh ç'dinte. Po e mbajti veten. «Do të zgjatet fjala, mendoi, e do të prishet mësimi. Më mirë si të mbarojë kjo orë.» Po as në fund të orës së mësimit nuk i tha gjë mësuesit. «Mund të mendojë se e kam zili Mbù-



rravecin — tha me vete. — Pastaj më-  
suesi do të thotë: «Mirë ai, që i tillë qenka,  
po ju? Kaq budallenj u ndodhët ju sa ai t'ju  
heqë për hunde? Po deri tani ç'kini bërë?»  
«Jo, nuk bën — vendosi — nuk bën!  
Këtë duhet ta zgjidhim vetë ne. Eh, or  
shokë! A nuk do të kuptoni edhe tani?»

Kur u kthyen nga shkolla, ai u kujdes  
që të ishin bashkë gjithë shokët. I tha  
Albertit:

— S'ke ç'i bën e ke në thua ti!

Tjetri e shikoi me habi, se e kuptoi që  
këto fjalë i tha me tallje. Po nuk e bëri  
veten.

— Ti më ke zili! — ja ktheu nëpër  
dhëmbë.

— Pse të të kem zili ty? Ke marrë më  
shumë dhjeta se unë? Sa orë ndënje mbrë-  
më duke studjuar?

— Asnjë!

— Zër be!

— Për kokën e babit s'i kam hapur  
fare librat!

— Mos u beto kot!

— Pse kot? Jo...

— Ua, sa i mençëm është, ore! S'i hap

fare librat, s'mëson fare, megjithatë merr dhjeta! E ka prej natyre!

— Qenam, shiko, se!..

Qenami vazhdoi me të tijën:

— Dëgjoni, o shokë! — u tha të tjerëve që, veç Taqos, s'kuptonin gjë e dëgjonin të çuditur. — Ky trimi, që ju ja kini aq shumë frikën, na qënka një mburravec. . .

Alberti u sul ta godiste, po të tjerët, për të parën herë, guxuan e i thanë të priste gjer në fund. Qenami vazhdoi:

— Ndërsa ne na thotë që nuk zë libër me dorë e të tjera si këto, që ju i dini, vetë e dini ç'bën? Mëson natën! Dhe pas-taj mburret se e ka në thua!

— Gënjen! — thirri Alberti.

— Le të tregojë Taqua! — tha Qenami.

Të gjithë vështruan djalin e vogël. Alberti i hodhi një vështrim plot inat Taqos, po ky që i kish mbetur peronë në zemër ajo puna e pantallonave dhe që vetëm tani i kish kuptuar drejt shumë veprime të «komandantit», tha se si e kishin parë mbrëmjen e kaluar. Alberti u mundua të gënjente duke thënë se lexonte një libër me tregime, po Taqua, duke i çuditur gjith-





një e më shumë të tjerët, thirri:

— Mos gënje, mos gënje! Ti lexoje historinë e gjeografinë!

Të gjithë e shikuan Albertin me përçmim. Për të parën herë ai uli kokën e s'foli. Duhet ta dini se fajtori, sado i fortë qoftë, mposhtet kollaj. Kështu ndodhi edhe me Albertin. I fortë ish ky, po s'foli fare, se shokët e kishin zënë me presh në duar. Po mos kujtoni se kërkoi ndjesë, ama! Vërtet e uli kokën e s'e ngriti tërë udhës, vërtet mendohej dhe e kuptonte se kish vepruar keq, po s'e hante dot që ta poshtëronin kaq keq dhe i vinte shumë inat që s'i jepte dot një përgjegje të mirë atij zezekut. Tani veç atij ja kish inatin. Pendohej që s'kish provuar ta nënshtronte edhe atë dhe mendohej të gjente mënyrën si t'ia nxirrte tërë këtë inat.

Qenamit nuk i pëlqeu që Alberti s'bëri kthesë. Kështu shoqëria e djemve të mëhallës ish e përçarë përsëri. E ç'u kuptua atëhere? Ç'kishin fituar? Asgjë! A nuk do të qe më mirë t'ja thoshin të gjitha mësuesit kujdestar? S'kish rrugë tjetër. Kështu vendosën. Po u desh edhe një provë tjetër dhe ngatërresa u zgjidh vetiu.



Një të diel po laheshin në një pellg. Me ta ish edhe një djalë i huaj. Ai notonte shumë mirë. Një herë ai i ra pellgut tej për tej duke notuar më kurriz. Kjo i habiti të gjithë. Si iku ai, Alberti tha se mund të notonte si ai djali, për t'ë s'ish ndonjë gjë e madhe! Disa s'e besuan dhe ai i inatosur vajti në anë të pellgut, u kthye në kurriz dhe u hodh. Po s'bëri më tepër se dy-tre metra, kur këmbët iu varën poshtë dhe ai po fundosej. U mundua ta mbante trupin pezull duke i përplasur duart. Të gjithë e kuptuan se sa t'i lodheshin krahët do të zhytej në ujë e do të mbytej, sepse atje ish shumë thellë. Njëri u hodh ta ndihmonte, po, sa e kapi për dore Alberti, u zhytën të dy në ujë. Kur duallën përsëri lart, Qenam-i ish pranë tyre. Kish marrë me vete dy shkopinj. Ua zgjati duke u thënë:

— Kapuni pas shkopinjve!

Pas pak dualën të tre. Shokët i rrethuan. U deshën disa minuta sa ta merrnin veten. Alberti e vështroi disa herë Qenam-in. Më në fund i tha:

— Ke të drejtë, Qenam. Vërtet paskam qenë një mburravec i keq! — dhe e uli kokën.

S'tha asgjë më tepër. Po Qenami u gëzua. Alberti i kish thënë me sinqeritet këto fjalë e, meqë ish treguar i sinqertë, patjetër do të ndryshonte. Tani në atë shoqëri do të kishin një shok të mirë, të cilin kolektivi i klasës e kish shpëtuar nga rruga e shtrembër që kish zënë. Tani do të formonin një shoqëri të vërtetë, të mirë, dhe Qenami ndjehej shumë i kënaqur kur e përfytyronte këtë shoqëri.



## PENDIMI

**B**ilbilin, atë djaln e vogël plot shëndet e gjallëri, në shkollë shokët e tij e njihnin edhe me një emër tjetër. I thërrisnin dhe gënjeshtar, edhe Bilbil Gënjeshtari. Kur tregonte ndonjë gjë të pabesueshme, dikush do të ndodhej atje për t'ja punuar atë rrengun që e kish shumë inat: ja shtyp-te majën e hundës me gishtin e madh duke bërë «bi!» si korner. Pastaj ja lëshonte dhe, duke ja parë majën e hundës plloçake, që i qe zbardhur nga largimi i gjakut, thosh:  
— Gënjen, gënjen! Mos e besoni!

Bilbilit i vinte të hajë veten me dhembë nga inati, po ç'të bënte? Kur ngrihej në mësim e s'e dinte, ai thosh kokulur si për mëshirë:

— S'jam përgatitur, shoku mësues, më dhimbte koka...

Ose:

— Ish nëna e sëmurë, shoku mësues, e s'e kisha mëndjen për të mësuar...


Këto fjalë i thosh me aq siguri sa që, po të mos e njihje, jo veç që do ta besoje, por edhe do të të vinte keq për të.

Klasa e tij kish shumë nxënës e rrallë i vinte radha për ta ngritur. Po ai e kish keq me detyrat e shtëpisë. Ato janë të përditshme. Ai shpesh përtonte ose s'dinte t'i bënte dhe të nesërmen trillonte gënjeshtër: «M'u mbarua fletorja e dyqani që i mbyllur.», «S'kisha bojë, shoku mësues...», «Kisha vrarë gishtin e s' shkruaja dot.», e të tjera si këto. Kështu pra, ai ish bërë përtac e nga kjo edhe gënjeshtar. Njeri ves sjell tjetrin. Në klasat e mëparshme kish qënë nxënës i mirë, prandaj tani shokët e mësuesit çuditëshin me ndryshimin e tij. Ja ç'ndodhi me të një ditë në mësimin e gjuhës. Mësuesi shënoi mungesat në regjistër, pastaj tha:

— Detyrat! Nxirrni shpejt detyrat e shtëpisë!

Atë ditë detyra e shtëpisë që mjaft e vështirë. Klasa u vu në lëvizje. Brënda minutës nxënësit i hapën mbi bangë fletoret e detyrave. Bilbili s'që bërë gati. Kër-





konte në çantë. Më mirë të themi që bente sikur kërkonte.

— Bilbil, akoma?

— Ja, shoku mësues, s'po e gjej dot fletoren...

Mësuesi priti edhe pak. Kaluan edhe disa çaste, Bilbili, duke shikuar vjedhur nga mësuesi, i shikoi disa herë librat e fletoret

e çantës së tij. Po fletorja e detyrave nuk po gjendej. Mësuesi po priste. Ai shikonte i qetë Bilbilin. Klasa kish rënë në heshtje. Nxënësit e kuptuan që këto detyra po kontrolltoheshin me një qëllim të caktuar, jo si herët e tjera, dhe prisnin çdo të ndodhte. Dikush foli ngadalë:

— Nuk i ka bërë detyrat. Kot bën sikur kërkon. . .

— Posi, o, s'i kam bërë?! — iu kthye Bilbili atij që foli.

— Bilbil, kush të dha leje për të folur? — tha mësuesi.

— Po ja, shoku mësues, pse të thotë ashtu? dhe Gënjeshtari u duk si i prekur në sedër.

— Ndoshta ai thotë të vërtetën.

— Jo, shoku mësues, unë i bëra detyrat.

— Po pres, atëhere. Gjeje fletoren e ma trego!

Si kaloi edhe pak kohë dhe fletorja s'po delte, mësuesi e mori dhe e kontrollloi vetë çantën e Bilbilit. Gjeti aty një fletore gjuhe, po data e fundit e detyrës në t'ë ish e një jave më parë.

— Kjo është?



— Jo, i kam bërë në fletoren numur 2.

— Po ku e ke fletoren Nr. 2?

Nxënësi shikoi si për t'u shfajtuar.

— Do ta kem harruar në shtëpi! —  
tha me nxitim.

— E ke harruar vërtet? — pyeti mësuesi duke e shikuar me vërejtje.

— Në pushimin e madh vete e marr!  
— tha me guxim Gënjeshtari.

— Pse ta zgjatim kaq shumë? Më mirë që tani. Luan, shkoni me Bilbin në shtëpinë e tij dhe merreni fletoren që e ka harruar atje!

Një nxënës kërkoi leje:

— Me leje, shoku mësues? Mos e dërgo Luanin, se do ta rrahë!

— Si, si!? Ç'do të thotë kjo?

Nxënësi u detyrua të sqaronte se si dikur Luani me Bilbin ishin shokë të ngushtë, po tani nuk shkonin mirë. Një ditë Luani i kish thënë mësuesit kujdestar se Bilbili s'mësonte fare, po loste nëpër fshat. Këtë e kish thënë edhe në mbledhjen e klasës. Bilbili e kish quajtur shpifararak shokun e tij dhe i qe kërcënuar që t'ja merrte hakun, «do t'ja tregonte qejfin!»

— Aha! — tha mësuesi kur i mësoi

këto gjëra — Pse, kështu e kupton ti shoqërinë? Atë që mundohet të të ndihmojë, ti e quajtkë shpifarak? Jo, kështu s'bën, s'është mirë.

Mësuesi ndaloi pak e pastaj shtoi:

— Bilbili nuk do të veprojë kështu herë tjetër! Tani do të vejë me Luanin në shtëpi e do të kthehet bashkë me fletoren.

Të dy nxënësit dualën nga klasa. S'kalluan veç disa minuta kur trokiti dera. Ata ishin. Luani mbante në dorë fletoren e Bilbilit.

— Nuk i ka bërë detyrat, shoku mësues — tha ai. — Desh t'i bënte tani dhe më premtoi se do të ishim shokë të mirë e do të më jepte ç'të desha, po të mos ju tregoja juve. Unë s'pranova dhe ai më tha: «Unë s'vij! shko vetë në shkollë!» Mirëpo na dëgjoi i jati. Unë i thashë atij si qe puna. Babai u inatos e desh ta rrihte Bilbilin, po pastaj ndërroi mendje e ardhë bashkë me ne. Tani u fut në drejtori.

Atë çast u hap përsëri dera dhe hyri brenda drejtori me një fshatar vetullngrysur. Bilbili rrinte kokulur prapa derës. Ardhi dhe mësuesi kujdestar.

— Shkoni në vend! — u tha mësuesi



të dy nxënësve — Uluni ju! — u tha të tjerëve që ishin ngritur e po rrinin në këmbë.

Mësuesi i gjuhës tregoi si ish puna. U ngritën edhe disa nxënës dhe folën për sjelljen e keqe të Bilbilit. Bilbili rrinte kokulur e bënte sikur qante.

— Që kur është bërë gënjeshtar Bilbili? — dëgjoji të pyesë drejtori.

Që kur ish bërë gënjeshtar ai? Kjo kish ndodhur çka kohë më parë. Një ditë i ati e kish mbajtur, se kishin për të mbledhur misër. I ati dhe e motra korrnin. Ai mbushte koshat. Punuan kështu mjaft. Bilbili u lodh e s'mësoi dot. Edhe detyrat s'pati kohë t'i bënte. Pra të nesërmen vajti në shkollë pa mësuar e pa i bërë detyrat. Po sikur ta ngrinin? Ç'do të bënte, si do të thosh? Nuk e merrte dot me mend se si do të sillej të nesërmen në klasë. S'i kish qëlluar ndonjëherë që të ngrihej e të mos dinte asgjë nga mësimet e ditës. Dhe kur s'i di mësimet, të duket vetja si i humbur, s'të bën zemra as të bisedosh me shokët e as të lozësh me ta. Në raste të tilla dëshiron të bëhesh i padukshëm e të mos i biesh në sy askujt, po të tërhiqesh mënj-

në gjer të kalojnë ato orët që zgjaten e zgjaten pa mbarim. Natyrisht këto i ndjen një nxënës i mirë. Deri atëhere Bilbili ish i tillë, prandaj edhe atë ditë, kur qe i papregaditur, ai e pati vështirë. Kur kishin filluar mësimin, atij i pat dhembur koka, ndoshta nga mendimet e shqetësimet që e kishin pushtuar. Duke ndënjur në bangën e tij, i mblodhi me forcë qepallat dhe u prish në fytyrë. Mësuesi e pat vënë re.

— Bilbil, si e ke punën? Koka të dhemb? — e pyeti ai.

Bilbili qe ngritur në këmbë flakë i kuq në fytyrë dhe me zë të ulët mezi kish pohuar se me të vërtetë i dhimbte koka. S'do mend që në mësimet s'e ngritën atë ditë dhe askujt s'i shkoi ndër mend që t'ja kontrollonte detyrat, bile i thanë edhe të shkonte në shtëpi, po të mos duronte dot. Po ai ndënjë aty dhe dëgjonte në heshtje të plotë. Në orët e tjera nuk i dhimbte koka, po ai gjeti rehat e s'lëvizti fare. Nuk vepronte kështu me ndonjë qëllim të caktuar, mirëpo shpesh vetiu ose pa dashur hyjmë në një rrugë që, po ta gjykojmë e ta shohim mirë që më parë, jo vetëm që nuk do të ecim më tej, por do të kthehemi me nxi-



tim prapa. Dhe e keqja është se rrugët e tilla që na dalin përpara papritur e pakujtuar, në fillim duken të drejta e të sheshta, po më pas vemë re me habi se të shpien në greminë. Kështu i ndodhi edhe Bilbilit. Ai më pas ndjehej fare mirë, por të gjithë e dinin të sëmurë. E ç'humbiste ai se të rrinte në heshtje atje në bangën e tij? Ajo dhembja e kokës e kish shpëtuar për bukuri, sepse, siç thamë, që në mëngjez atij i pëlqente të veçohej nga shokët, të cilët patjetër do të bisedonin sado pak gjatë pushimeve për orën e ardhme të mësimit. Sa të turpërohëj, më mirë rrinte mënjanë. Më pas duke menduar për hollësitë e kësaj dite, ai thosh: «Po sikur të kisha thënë kot që më dhimbte koka? E njëjta gjë do të ndodhte. A nuk më ka thënë Hydriu se kështu bënte kur ish i papregatitur në mësime? Po jo, unë s'mund ta bëj këtë, nuk e bëj kurrë! «Bilbili betohej me vete, po mendimi që atë ditë të vështirë e kish kaluar aq lehtë me një dhembje të vogël koke, s'i ndahej asnjë çast. Qëlloi edhe herë të tjera që të jetë i papregatitur. Në këto raste ai gënjeu, tha se ish i sëmurë. Gënjeu një herë, dy, dhe ja ku iu bë zakon ky ves që i qe dukur i ëmbël e shpëtimtar. . .

...Tani rrinte kokulur e dëgjonte ç'thoshin për të. Të gjithë për atë flisnin! Kjo mbledhje ish bërë për të! Të gjithë flisnin kundra tij! Asnjë s'e ndihmonte.

— Shikoni si e mban kokën ulur! Nuk ka sy të na shikojë. Kush e mban kokën ulur? Kush nuk ka guxim t'i shikojë njerëzit në sy? Fajtori! Gënjeshtari! Ai gënjeu mësuesin, shkollën, familjen... veten e tij! Harroi se kjo është një cilësi e personazhëve negative. Nxënësi duhet ta mbajë kokën lart, të jetë ballëhapur!...

Kush fliste kështu? Ai s'dëgjoi dot më tej. Dikush po i afrohej. Një dorë e ashpër e kapi për veshi. Veshi i dhëmbi keq. Dorë të tillë kish i ati. Ai kapte kështu për veshi si me darë. Bilbili e kuptoi. Ai e njihte të atin dhe po priste me zëmër të ngrirë ç'do të bëhej më tej.

I ati ish vërtet. Ai s'kish duruar dot më tepër. Tha me zë të vrazhdë:

— Ngreu më këmbë! A e di përse kam ardhur këtu? Për ty! A e di përse po rri kështu vetullngrysur? Prej teje! Kam qenë fukara kur isha sa ti. Kam mbetur i verbër, s'di as të shkruaj, as të këndoj. S'kam



patur faj unë për këto. Por turp të tillë nuk kam provuar kurrë, dëgjon? Kurrë! Kur hyra këtu, m'u duk sikur më ra shkollla mbi kokë. Kam turp t'i shoh në sy jo vetëm mësuesit, po dhe nxënësit, shokët e tu!

Babai i Bilbilit shikoi nga klasa. Sytë i kish të kuq, plot zemërim.

— Pa shikoi një herë të tjerët! — shtoi. — Veç tyre je ti? Unë të dija nxënës të mirë. Kohët e fundit s'para të kam parë të shkruash në shtëpi, po më ke thënë se s'kishit detyra, se i kishe bërë me shokët e proçka të tjera, që paskan qenë tërë gënjeshtër. Unë s'di të të kontrolloj dhe të kam besuar. Kam bërë gabim që të kam mbajtur ndonjëherë në shtëpi. E shoh se kam bërë gabim. Po s'ma merrte mendja as ndonjëherë që të bëheshe i këtillë e të ma nixije faqen kështu! Jo, s'e merrja dot me mend. Si!? Djali im gënjeshtar e dembel!? Për djalin tim të bëhet gjithë kjo?!

Pas kësaj ai i dha një dackë. Ish shumë me inat. I thanë se s'duhej në atë mënyrë. Bilbili deri atëhere kish ndënjur thua se pa marrë frymë.

Po ankthi qe shumë i madh e ai s'ish

përmbajtur dot më. Lëshoi një dënese të papritur, ngjethëse, që u shoqërua me lot të nxehtë, të cilët rridhnin si ato pikat e strehëve kur shkrin dëbora. Bilbili qante me dhëmbje. Supat i ngriheshin e uleshin nxitimthi. Ish tronditur nga fjalët e mësuesve dhe të babait të tij. Ish tronditur nga kjo mbledhje e çuditshme në mes të mësimi, që ish bërë vetëm për të. Dhe qante me dhëmbje, sepse tani e kish parë me habi greminën ku e kish shpënë rruga që i qe dukur e shtruar. Kish gënjyer, sepse kish përtuar t'i bënte detyrat e të mësonte. Nganjëherë kish gënjyer dhe kot, pa i vënë rëndësi, duke dashur të tallej me shokët. Po s'mendonte se kjo mund të bëhej kaq e madhe. Nuk mendonte kurrë se do të ndodhej një herë kaq ngushtë. Tani desh të thotë se sa shumë ish penduar. Desh të thotë se sa shumë e ndjente atë që kish bërë. Desh të premtonte se do të bëhej nxënës i mirë. Desh... por nuk kish guxim. Mendoj se do të kujtonin që i gënjen te përsëri. Kjo i theri në zëmër.

Dhe pendimin e tij, tërë ato që desh të thotë, i shprehte me lot, me atë të qarë ngashëryese.



Por ata që u ndodhën atje, i kuptuan  
ato që s'mundi t'i thotë Bilbili. I kuptuan  
dhe e falën.

Më pas atij nuk ja shtypi njeri më  
majën e hundës. Gënjeshtar askush s'i thë-  
rriti më. Dhe kjo nofkë u harrua më shpejt  
nga sa besonte ai.

LETËR NGA FSHATI

Andoni kish marrë një letër nga i kushëriri, Ylli, që banonte në qytet. Ylli i shkruante që nga kampi i pionierëve në Durrës. Andoni e kish menduar disa herë përgjegjen që do t'i kthente, por s'po i mbetej kohë, se punonte në kooperativë. Më në fund, në një pushim të vapës, shkrojti me kalem në një fletë:

«I dashur Ylli!

Të shkruaj unë, kushëriri yt, Doni. Ti më shkruaje që nga kampi i pushimit dhe thoshe se pa e lexuar letrën unë s'mund ta gjej dot se ku ishe. Po ti, a mund ta gjesh dot se ku jam unë? Ve bast që s'të bie ndërmënd! Jam tek lisi i madh i Gjergjit. A të kujtohet ky lis? Këtu kemi mbledhur shumë herë bashkë lëndë për derrin.

Tani është mezi i ditës. Bën vapë. Të



vriten sytë, po të shikosh rreth e rrotull. Çdo gjë duket si e zhuritur nga e nxeha. Edhe pemët këtu duken si pa jetë, sepse janë mbuluar me aq pluhur, sa zbardhin. Në ajër dëgjohet një gumëzhitje e mërzi-tëshme. S'e merr dot me mend sa lloj mi-zash e insektesh ka tani në verë!

Por këtu, nën lis, është fresk. Ky lis i madh ka hie të trashë. Hedh sytë përpjetë dhe shoh se si kërcejnë nga një degë në tjetrën një tufë zogjsh. Edhe ata, me siguri kanë ardhur këtu të mbrohen nga vapa e madhe.

Sa herë ndodhem këtu, rri e vras mendjen. Vërtet është për t'u çuditur: Si është rritur kaqë ky lis? Sa formë të bukur që ka! Si ombrellë e madhe, e madhe. Dhe sa i fortë është! Kushedi sa qindra vjet do të ketë bërë hie mbi këtë lëndinë të bukur! Ndoshta është që në kohën e Skënderbeut. Kushedi sa njerëz ka parë të rrinë nën të!

Por ti mos kujto se kam ardhur këtu për të ndenjtur nën hie. Unë sivjet, o kushëriri im, punoj në kooperativë! Mos kujto, se të gënjej! Ndhimoj prindët. Gjer tani kam vënë tridhjetë ditë pune!

Ka nja dy javë që punoj me ormanxhinjtë. Ormanxhinj u thonë atyre që shijnë grurin me kuaj. Unë i ngas kuajt në lëmë. I kemi ngarë një herë bashkë vjet te lëmi i Donaçit. Të kujtohet? Po atëherë i ngisnim për qejf. Ndryshe është t'i ngasësh me orë të tëra.

Dielli të bie mbi kokë, si saç. Lodhesh e





duhet durim. Mirpo, lehtësohesh e ke kënaqësi kur mendon se punon për kooperativën tënde, për interesin e gjithë fshatit.

Tani sapo e nxuarëm vrahun. Burrat po e hedhin grurin, ndërsa unë i kam sjellë kuajt këtu të çlodhen e të kullosin ca, se pastaj do të vemë të sjellim duajt të tjerë. Një pjesë të duajve i marrim në mëngjes. Ngrihemi pa hapur dita, se, kur bie dielli, duhen futur kuajt në lëmë. Në fillim mezi zgjohesha herët. Më flihej aq shumë, Ylli, sa më vinte të shtrihesha në rrugë, mbi kalë a kudo dhe t'ija merrja përsëri me gjumë. Po tashti u mësova dhe zgjohem vetë, kur vjen koha. Ta dish sa kënaqësi qënka në mëngjes herët! Ajri është i pastër dhe i freskët, zogjtë këndojnë si në pranverë. Ne, hipur në kuaj, shkojmë nëpër ara. Nganjëherë kapim ndonjë lepur a thëllëzë që fshihen nëpër duajt. Një mëngjes mu në këmbët e mia ja bënë «për!» nja katër thëllëza. I përplaskan aq me nxitim ato krahët e shkurtër, sa dëgjohen sikur fërshëlajnë. Ta them vetëm ty, Ylli, që u trëmba shumë në atë çast, po s'e bëra veten.

Këto që shkrojta, Ylli, janë të vërteta.

Mos thua j që po të mburrem. Dhe asnjëri s'më ka detyruar të punoj. Po sivjet ne vendosëm, tërë klasa, që të punojmë verës. Punon edhe Koçua, Miti, Kici... Pas punës mblidhemi tok shpesh dhe bisedojmë. S'na mban vendi, kur kujtomë se sa do të kënaqet mësuesi ynë kujdestar kur të marrë vesh si i kemi kaluar pushimet verore! Ai është shumë i dashur, Ylli, dhe kënaqet pa masë kur ne bëjmë punë të mira.

Po ti, ç'po bën tani? Thoshe se do të vinit nëpër fshatra për të ndihmuar në punët e bujqësisë. A vajtët vërtet? Po të kini vajtur, të më bësh një letër të gjatë, ja, kështu siç po të shkruaj unë, e të m'i tregosh të gjitha.

Po libra, a ke lexuar? Të të them të drejtën, gjatë pushimeve unë s'kam lexuar asnjë. Lexoj vetëm gazetën e revistat që sjell përgjegjësi i vatrës së kulturës në qendrën e agjitacionit. Më vonë, si të mbarojnë të shirat, do të kemi kohë dhe atëherë do të lexoj plot...»

Andoni po mendohej ç'ti shkruante më të kushëririt, po vuri re se s'kish fletë tjetër me vete dhe, veç kësaj, ish zgjatur



shumë. E lexoi edhe njëherë letrën, e palosi dhe u ngrit. E ndjente veten të rritur e të fortë. Ndjehej krenar që kish bërë një letër kaqë të gjatë, sepse kish patur ç't'i shkruante.

Ai vajti te burimi që ndodhej aty pranë, u shtri barkaz dhe piu me etje. Kur mori frymë për të pirë prapë, vuri re se që poshtë e shikonte një goxha djalosh, me flokë të gjatë e me fytyrë të pjekur nga dielli. U kujtua atë çast se rrobat, flokët, bile dhe qepallat, sikur i qenë zbardhur e zhuritur nga dielli. Të tillë e kish parë veten rastësisht në pasqyrë një ditë më parë. Qeshi me vete.

«Po të më shohë kështu, Ylli, s'do të më njohë fare. Unë mezi e njoha veten.»

Atëkohë dëgjoi se po e thërrisnin! I lidhi kuajt njerin pas tjetrit, i hipi të parit dhe u nis për tek lëmi, ku do t'i ngarkonin me grurin e ri. Pasi ta shpinin grurin në depo, do të shkonin për të mbajtur duaj, si ditët e tjera.

## NË MBLEDHJEN E KLASËS

**S**i çdo javë, të Shtunën u bë mbledhja e klasës. Nxënësit e dinin se në këtë mbledhje do të bëhej fjalë për sjelljen në shkollë e jashtë saj.

Në mbledhje ish edhe mësuesi kujdestar. Ai u ul në një bangë, ndërsa një nxënës, Agimi, u ngrit më këmbë. Në dorë mbante një dyfletëshe të shkruar. Nga sa dukej, ai ish përgatitur në mënyrë të veçantë për të folur.

Fjalët e para që tha, ishin të përgjithshme e nuk po dëgjoheshin me vëmëndje. Por papritur, Agimi pyeti:

— Kështu duhet të jetë një nxënës me edukatë. Po a jemi ne, të tillë? A jemi ne të sjellshëm kudo, si nxënës të edukuar?

Agimi pyeti kështu dhe e hodhi shikimin nëpër klasë, sikur kërkonte përgjegje



prej ndonjerit. Vështrimi i tij u ndal si pashur tek Sazani. Ky rrinte në një bangë aty afër. Ndërsa të tjerët lëvizën plot kurreshtje nga këto pyetje, ai dukej si i hutuar, sikur e ndjente veten të tepërt atje. Shoku i bangës e shpoi me bryl.

— More, ku e ka hallin Agimi, ë? Për cilin ta ketë fjalën? Si thua? Apo foli ashtu kot?

Tjetri u hutua edhe më tepër.

Sa filloi përsëri Agimi, asnjë s'lëvizi më.

— Pyeta kështu — tha ai — se shumë nga ne kujtojnë që po të rrimë urtë e mirë në shkollë, po të mësojmë mirë e të përshëndesim njerëzit në rrugë, atëherë jemi tamam nxënës të mirë e me edukatë. Mirëpo nuk është kështu. Dëgjoni një ngjarje të vogël dhe pastaj bisedojmë për këtë gështje:

«Një ditë po kthehesha nga shkolla me një nga shokët e mi. Tek shtëpia e tij i uruam njeri-tjetrit drekën e mirë e pastaj ai hyri brënda, ndërsa unë ndënja aty, tek qoshja, se po më thërriste një shok tjetër, që ta prisja. Po rrija atje pra, duke pritur, kur dëgjova sipër meje, atje ish

një dritare, zërin e shokut me të cilin sapo ishim ndarë.

«Bukë! Akoma s'po më sjell bukë?!

«Ngadalë, bir, ti s'ke hyrë mirë në shtëpi!» i tha e ëma.

«Dua bukë, moj, dëgjon ti? Oj, një orë mezi të të japin të hash!»

Si tha këto, shoku e hodhi çantën e librave diku, ndoshta mbi karrige, dhe rrëzoi diçka me potere.

Pas pak, e ëma i tha:

«Ja, ha e mos thirr kështu, se është turp.»

Po nuk mbaroi me kaq muhabeti.

«Pse, me qepë e ke bërë mishin, a?! Pse s'e bërë me patate?! Unë dua mish me patate!»

Kështu thirri përsëri ai shoku. E ëma mundohej ta bindte.

«Eh, mor dajlë! — i tha — I vogël s'je tani. E ku të gjej mish me patate?»

«Nuk e di unë! Gjeje ku të duash. Unë dua mish me patate!»

Dhe pastaj shoku im filloi të çirrej e të përplaste këmbët.»

Agimi përsëri e shikoi me bisht të syrit Sazanin, i cili e kish ulur kokën dhe s'ndihej fare. Kish edhe ca që rrinin të



heshtur. Po të tjerët prisnin me padurim të mësonin cili qe ai shok i Agimit.

— Kaq dëgjova unë — vijoi ky — se shoku që prisja, arriti dhe të dy vazhduam rrugën. Tani duhet t'ju them edhe se shoku që u suall kaq keq me t'ëmën, nuk është dosido. Ai është një nga nxënësist më të mirë të shkollës në mësim. Ne e dinim si një nga shokët më të mirë, po që atë ditë unë kam vënë re se, në lodra e kudo, ai do që të shkojë gjithë fjala e tij. Pra, ky nxënës vete mirë me mësim, në klasë rri mirë, po jashtë nuk tregohet i sjellshëm; a mund ta quajmë me edukatë?

— Jo! — thanë nxënësit njëzëri.

Sazani nuk tha dot jo. Ai ish si ndër ethe. Dëgjonte si nëpër gjumë. Koka i buçiste e veshët i zjenin. Fytyra e përskuqur i digjej nga të nxehtit. Agimi kish folur për të. Ai i kish dëgjuar nën dritare fjalët e tij dhe këto ua tha të gjithëve. Sazanin gjithmonë e kishin lavdëruar, kurse tani. . . .

Ai në fillim mori inat kundrejt Agimit që kish folur për të. Pastaj mendoi se Agimi do t'ja kish treguar patjetër mësuesit diskutimin e tij. Atëhere i erdhi më tepër turp. Nuk e ngriti më kokën, se kish

frikë mos haste vështrimin e ndonjerit, si-  
domos të mësuesit.

...Në klasë bisedonin lirisht. Njeri  
thosh se jo vetëm që nuk i kundërshtonte  
s'ëmës, po edhe e falnderonte për çdo gjë  
që i jepte. Një tjetër thosh se e ndihmonte  
nënë në punët e shtëpisë, sepse i vinte  
keq për të.

Këto fjalë Sazanit i dukeshin si gjil-  
përa të skuqura që i futeshin në zemër.

Papritur njeri pyeti:

— Po cili është ai nxënës? Pa ta ma-  
rrim vesh një herë!

— Vërtet, cili është? — pyetën edhe  
ca të tjerë.

Sazani do të desh ta përpinte dheu  
atë çast. Po priste zëmërdredhur të dë-  
gjonte emrin e tij, kur mësuesi tha:

— S'ka rëndësi se cili është. Këtu,  
midis nesh, mund të jetë. Ndoshta janë  
disa e jo veç një që veprojnë në këtë më-  
nyrë.

Vërtet, veç Sazanit në klasë rrinin  
kokulur e të heshtur edhe tre a katër  
nxënës.

Të tjerët kërkonin të tregohej patje-



tër se cili qe ai. Mësuesi nuk u përgjegj.  
As Agimi.

Kur ja, u dëgjua një zë i mekur:

— Jam unë... unë...

Ky ish zëri i Sazanit. Ish ngritur në këmbë dhe, flakë i kuq në fytyrë, kokulur si gjatë tërë kohës së mbledhjes, mezi kish thënë këto dy fjalë.

U bë heshtje. Disa lëshuan edhe një «ah» habie. Askujt s'ja merрте mëndja për Sazanin.

Sazani u ul pa shtuar dot ndonjë fjalë tjetër...

Mbledhja mbaroi. Sazani doli me nxitim nga klasa dhe iku vetëm përpara. Nxitonte për në shtëpi. Atje ish sjellë aq keq. Atje ja kish vënë vetes atë njollë, atje edhe mund ta hiqte.

Sa hyri brënda, i tha s'ëmës:

— Më fal, mama! Unë shpesh jam sjellë keq me ty. A do të më falësh?

E ëma e dinte si qe puna, se kish biseduar me mësuesin. Ajo e puthi me dashuri dhe i tha se e falte. Sazani u hodh në krahët e saj duke qarë: nuk e kish mbajtur dot më tej shtrëngimin që ndjente në gjoks.

## TRYEZA E LËNDËS

	Face
Tirka . . . . .	3
Xhaketa . . . . .	23
Kornizat . . . . .	36
Në verë . . . . .	52
Ndërgjegja . . . . .	69
Mburraveci . . . . .	83
Pendimi . . . . .	97
Letër nga fshati . . . . .	110
Në mbledhjen e klasës . . . . .	116



Tirazhi 6000 kopje      Format 70 x 100 /32      Stash: 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1967